Marrëdhëniet Ndëretnike dhe Pajtimi në Kosovë: Narrativat Politike dhe të Mediave në Perspektivë

Raport i Politikave
Nëntor 2025

Përgatitur nga:

Dr. Lulzim Peci
Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)
Rr. Major Mehmet Bushi, H.III/1, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 (0)38 542 778
Web-site: www.kipred.org
Email: info@kipred.org

Raporti i politikave "Marrëdhëniet Ndër-etnike dhe Pajtimi në Kosovë: Narrativat Politike dhe të Mediave në Perspektivë" është përgatitur me mbështetjen e projektit rajonal ***"SMART Balkans – Shoqëria Civile për Vlera të Përbashkët në Ballkanin Perëndimor"*** *të zbatuar nga Centar za promociju civilnog društva (CPCD) në bashkëpunim me Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM),dhe Qendra për Kërkim dhe Politikëbërje (CRPM) dhe i mbështetur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë (NMFA). Përmbajtja e këtij raporti të politikave është përgjegjësi e vetme e Institutitit Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED) dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë (NMFA).*

E drejta e autorit:

Copyright © 2025, KIPRED. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e kësaj botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në asnjë sistem rikujtues ose të transmetohet, në asnjë formë dhe me asnjë mjet, elektronik, mekanik, fotokopjim, regjistrim apo tjetër, pa autorizimin paraprak me shkrim të botuesit. Ju lutemi kontaktoni: info@kipred.org, ose +383 38 542 778.

Tabela e përmbajtjes

Përmbledhje Ekzekutive 4
Hyrje 7
1. Narrativat e Liderëve Politikë dhe Marrëdhëniet Ndëretnike 8
2. Diskurset Politike dhe të Mediave: Shoqëria Civile dhe Marrëdhëniet Ndëretnike 15
3. Midis Përmbajtjes dhe Polarizimit: Mjedisi Medial i Kosovës për Marrëdhëniet Ndëretnike 22
4. Analiza e Sondazheve të Opinionit 38
Konkluzione dhe Rekomandime 47

Përmbledhje Ekzekutive

Ky punim shqyrton atë se si dinamika politike, e shoqërisë civile, e medias dhe e opinionit publik i trajtëson marrëdhëniet ndëretnike dhe pajtimin në Kosovë. Studimi heton se si aktorët kryesorë i formulojnë narrativat për marrëdhëniet ndëretnike, si këto narrativa udhëtojnë nëpër ekosistemet mediatike dhe si ato perceptohen nga qytetarët në të gjitha komunitetet.

Empirikisht, punimi i ndërthur katër fille. Ky së pari i analizon intervistat gjysmë të strukturuara me katër figura të larta politike (PDK, LDK, AAK dhe Ministri për Kthim) së bashku me një kodim të bazuar në rregulla të postimeve të partive të tyre në Facebook midis shtatorit 2022 dhe tetorit 2024. Së dyti, ky i shqyrton intervistat me organizatat kryesore të shoqërisë civile të angazhuara në dialog, drejtësi tranzicionale dhe të drejtat e komuniteteve jo-shumicë. Së treti, ky i vlerëson rrëfimet e gazetarëve dhe të redaktorëve për praktikën e tyre, dhe kjo plotësohet nga një analizë narrative e mbulimit të 16 mediave të botuara në gjuhën shqipe dhe serbe nga shtatori 2022 deri në tetor 2024. Së fundmi, mbështetet në një sondazh omnibus përfaqësues kombëtar (N≈1,165) të kryer në shtator 2025 për t'i kapur pikëpamjet e qytetarëve mbi marrëdhëniet ndëretnike, mediat dhe narrativat politike.

Dëshmitë cilësore trajtohen si paraqitje ekspertësh për mjediset dhe kufizimet diskursive, ndërsa përmbajtja e medias dhe e mediave sociale është koduar në kategoritë pajtuese, të vijës së ashpër/të përqendruara në siguri, stigmatizuese dhe neutrale; anketa e ofron një pamje nga poshtë-lart të prioriteteve normative dhe të modeleve të besimit.

Gjetjet për diskursin elitës politike janë të zhveshura. Të gjithë udhëheqësit e intervistuar pajtohen se marrëdhëniet ndëretnike janë përkeqësuar, edhe pse ata theksojnë shtytës të ndryshëm për këtë, nga bojkotimi serb dhe instrumentalizimi i komuniteteve joshumicë të tjera e deri te qasjet "ligji para dialogut" dhe thellimi i mosbesimit midis nivelit qendror dhe atij lokal. Analiza sistematike e postimeve të partive në Facebook tregon se në VV, PDK, LDK, AAK dhe posaçërisht në Listën Serbe, komunikimi që ka të bëjë qartë me temat ndëretnike mbizotërohet nga kornizat e vijës së ashpër, të përqendruara në sigurinë-së-pari, me vetëm një pjesë të vogël të mesazheve pajtuese dhe, në rastin e Listës Serbe, me një shtrese të dukshme të përmbajtjes stigmatizuese. AAK mban një profil të përzier, por ende të sigurtë, ndërsa Nenad Rašići shfaqet si një përjashtim, ku komunikimi i tij është kryesisht jo-konfrontues. Së bashku, këto modele në ushqimin informativ të qytetarëve e normalizojnë një axhendë të përqendruar në konflikt dhe dërgojnë sinjale të përsëritura se dialogu është i jashtëzakonshëm e me rrezik, dhe jo një pjesë rutinore e jetës demokratike.

Udhëheqësit e shoqërisë civile që punojnë për pajtim e përshkruajnë një asimetri këmbëngulëse të ndikimit. Ata janë në gjendje të mbajnë kontakte ndëretnike, të kultivojnë një "mikro-besim" dhe të ndërtojnë kundër-narrativa përmes koalicioneve, edukimit qytetar, demistifikimit dhe rrëfimit të historive, mirëpo, që nga viti 2021, këto përfitime vazhdimisht rrënohen nga retorikat përshkallëzuese, fushatat e shpifjes, incidentet e sigurisë dhe ngushtimi i hapësirës qytetare. Delegjitimimi i ndërtuesve të urave si "bashkëpunëtorë," narrativat e pazgjidhura dhe konkurrente të luftës së viteve 1990 dhe pasiguria kronike e financimit e ngushtojnë edhe më

tutje hapësirën për punë të qëndrueshme dhe afatgjatë të pajtimit. Pamja kumulative nuk është ajo e dështimit, por e suksesit të kushtëzuar: progresi është i mundur, mirëpo ai duhet të rivendoset rishtas sa herë që aktorët shtetërorë dhe partiakë dërgojnë sinjale përjashtuese në vend të atyre qetësuese e inkurajuese.

Mjedisi mediatik qëndron midis përmbajtjes dhe polarizimit. Krahasuar me periudhën para pavarësisë dhe krizat si ajo e marsit 2004, mediat kryesore në gjuhën shqipe dhe serbe janë më të disiplinuara: ato kryesisht shmangin gjuhën eksplicite të urrejtjes, mbështeten në Kodin Kombëtar të Etikës, zbatojnë pragje më të larta verifikimi dhe përdorin gjuhë të deetnizuar dhe mbikëqyrje të nivelit më të lartë për t'i "ftohur" rrëfimet potencialisht shpërthyese. Mirëpo, strukturalisht, mbulimi mbetet i anuar drejt sigurisë, krizës dhe politikës së lartë, në vend se të bashkëjetesës së përditshme, interesave të përbashkëta dhe bashkëpunimit në nivelin lokal. Mangësitë gjuhësore midis gazetarëve, prania e dobët në terren në zonat me shumicë serbe dhe dy ekosisteme mediatike që në masë të madhe janë paralele, kombinohen për ta prodhuar një "stereotip të mungesës," në të cilin jeta e zakonshme ndërkomunitare në lajme shfaqet rrallë, ndërsa një brez i politizuar dhe i drejtuar nga klikimet përfiton nga identiteti dhe pakënaqësitë. Gazetarët raportojnë se veprojnë në një mjedis me presion të trajtësuar nga brishtësia ekonomike, tkurrja e mbështetjes së donatorëve, institucionet jotransparente, rrjetet militante online dhe nga propaganda ndërkufitare nga mediat e lidhura me Beogradin, ku të gjitha këto nxisin kujdes dhe vetëcensurë, dhe posaçërisht në veri. Në të njëjtën kohë, "ishujt profesionalë" tashmë modelojnë një praktikë më konstruktive përmes raportimit me më shumë burime që përfshin zërat e jo-shumicës, formatet e studiove të përziera, gjuhën që i jep përparësi qytetarisë dhe ndarjen e përbashkët të përmbajtjes ndërgjuhësore.

Sondazhi i opinionit publik shton një perspektivë thelbësore nga poshtë lart. Rreth 78% e të anketuarve i vlerësojnë marrëdhëniet ndëretnike dhe pajtimin si të rëndësishme ose shumë të rëndësishme në jetët e tyre, ku ky nivel i lartë i angazhimit normativ është gjerësisht i përbashkët midis shqiptarëve, serbëve dhe komuniteteve të tjera, si dhe midis grupeve të moshave dhe gjinive të ndryshme. Gati dy të tretat besojnë se politikanët e Kosovës duhet ta miratojnë një qasje më të qartë dhe më të hapur për promovimin e pajtimit ndëretnik, ku kundërshtimi i plotë është i kufizuar në vetëm 5% të mostrës. Në të njëjtën kohë, besimi te ndërmjetësit kryesorë është shumë i ulët. Vetëm rreth një e treta e të anketuarve shprehin besim në raportimin mediatik mbi marrëdhëniet ndëretnike, ndërsa afërsisht dy të tretat raportojnë se kanë pak ose nuk kanë fare besim, një model ky që është më i theksuar midis të anketuarve serbë, por është i dukshëm edhe midis shqiptarëve. Narrativat politike dhe mediat megjithatë shihen si shumë me ndikim: në të gjitha grupet shumica beson se të dyjat i formësojnë ndjeshëm perceptimet publike të marrëdhënieve ndëretnike. Megjithatë, shqiptarët kanë prirje që komunikimin politik ta shohin si lehtësisht të dobishëm për pajtimin, serbët në masë dërrmuese atë e shohin si të dëmshëm, dhe komunitetet joshumicë të tjera atë shpesh e gjykojnë si pa ndonjë efekt të vërtetë, duke zbuluar përvoja të theksuara divergjente të të njëjtit diskurs. Të marra së bashku, të katër shtyllat tregojnë një asimetri themelore. Nga ana shoqërore, ekziston një kërkesë e konsiderueshme latente për marrëdhënie ndëretnike më konstruktive dhe për një axhendë politike që pajtimin e merr seriozisht. Nga ana institucionale, aktorët të pozicionuar më së miri për t'iu përgjigjur kësaj kërkese – dhe posaçërisht elitat politike dhe mediat partiake – shumë

shpesh prodhojnë narrativa të sigurimuara dhe nganjëherë stigmatizuese që qarkullojnë në një mjedis informacioni me besim të ulët.

Si përmbledhje, studimi argumenton se Kosova nuk përballet me mungesë të kërkesës publike për pajtim, por me mungesë të ndërmjetësve dhe institucioneve të besueshme dhe të gatshme për ta përdorur fuqinë e tyre komunikuese që ta ndërtojnë besimin ndëretnik, në vend se që ta shkatërrojnë atë. Prandaj, dokumenti përfundon me rekomandimet e përqendruara që synojnë përafrimin e lidershipit, praktikës mediatike dhe nismave qytetare me këtë mandat të gjerë shoqëror.

Ky i bën thirrje Presidencës, Qeverisë, Kuvendit dhe partive politike që ta miratojnë dhe përvetësojnë një doktrinë të të folurit të përgjegjshëm që shmang gjuhën e urrejtjes, fyerjet etnike dhe fajësimin kolektiv, dhe që i hedh poshtë kornizat e ekzagjeruara të fokusuara në siguri që të gjitha komunitetet i paraqesin si kërcënime, duke përdorur gjuhë të bazuar në fakte që ul tensionet, dhe posaçërisht në kohë krize. Kjo duhet të rrënjoset në rregullat e partisë dhe të shoqërohet me garanci konkrete përmes zbatimit të vazhdueshëm të të drejtave gjuhësore, përfaqësimit proporcional të komuniteteve jo-shumicë në institucionet publike dhe konsultimit sistematik me përfaqësuesit e zgjedhur lokalë të komunitetit serb dhe të komuniteteve të tjera joshumicë.

Mediat publike dhe mediat më të mëdha private nxiten të investojnë në kapacitete dygjuhëshe shqip-serbisht dhe në projekte të përbashkëta editoriale, ashtu që temat e ndjeshme, të tilla si zhvillimet në veri të Kosovës, komunat e përziera dhe incidentet e sigurisë, të raportohen nga terreni dhe në një mënyrë profesionale, gjithëpërfshirëse dhe dygjuhëshe, me donatorët dhe rregullatorët që nxisin vetëpërmbajtje që nxjerr në pah bashkëjetesën, interesat e përbashkëta ekonomike dhe bashkëpunimin lokal.

Së fundmi, udhëheqësit politikë dhe zyrtarët shtetërorë duhet ta ndërpresin delegjitimimin e nismave ndëretnike, dhe në vend të kësaj ata duhet ta konfirmojnë publikisht punën e aktorëve të shoqërisë civile të angazhuar në dialog, në drejtësi tranzicionale dhe në të drejtat e komuniteteve jo-shumicë, duke siguruar që rrëfimi i historive mbi bashkëpunimin praktik ndër-komunitar të lidhet në mënyrë sistematike me mediat kryesore dhe lokale, në vend që të mbetet i kufizuar në raportet e projekteve.

Hyrje

Një çerek shekulli pas luftës së viteve 1998-1999, dhe më shumë se 17 vjet pas pavarësisë, marrëdhëniet ndëretnike dhe pajtimi mbeten thelbësore për strukturën shoqërore të Kosovës. Pavarësisht garancive formale të të drejtave të komuniteteve jo-shumicë dhe angazhimeve të përsëritura për dialog, krizat politike dhe të sigurisë në veri, ciklet e përsëritura të bojkotimit dhe retorika e polarizuar marrëdhëniet i kanë mbajtur të brishta.

Prandaj, ky punim bashkon katër pjesë empirike për ta hartuar peizazhin narrativ të marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë. Ky së pari shqyrton atë se si elitat politike i përkufizojnë marrëdhëniet ndëretnike, dhe këtë e bën përmes intervistave gjysmë të strukturuara me udhëheqësit kryesorë dhe një analize sistematike të postimeve të partive në Facebook nga shtatori 2022 deri në tetorin 2024. Së dyti, ky i analizon intervistat me udhëheqësit e shoqërisë civile që punojnë drejtpërdrejt në dialog, në drejtësi tranzicionale dhe në të drejtat e komuniteteve jo-shumicë. Së treti, ky shqyrton se si gazetarët dhe redaktorët në mediat kryesore në gjuhën shqipe dhe serbe e kuptojnë dhe e praktikojnë raportimin mbi çështjet ndëretnike, dhe ky shqyrtim plotësohet nga një analizë narrative e mbulimit në gjashtëmbëdhjetë media midis shtatorit 2022 dhe tetorit 2024. Dhe, në fund, ky mbështetet në një sondazh gjithëpërfshirës të opinionit përfaqësues kombëtar të kryer në shtator 2025 për ta kuptuar atë se si vetë qytetarët i shohin marrëdhëniet ndëretnike, median dhe narrativat politike.

Metodologjikisht, dokumenti kombinon mjete cilësore dhe sasiore. Intervistat e udhëheqësve politikë, të gazetarëve dhe të përfaqësuesve të shoqërisë civile trajtohen si dëshmi ekspertësh për mjediset diskursive, kufizimet institucionale dhe praktikat në terren. Mediat sociale dhe përmbajtja e lajmeve janë koduar duke përdorur një leksik të bazuar në rregulla, që bën dallimin midis mesazheve pajtuese ose që vënë në plan të parë dialogun, kornizave të vijës së ashpër ose të atyre që vënë në plan të parë sigurinë, të gjuhës stigmatizuese ose të asaj "tjetërfare," dhe të komunikimit neutral ose burokratik. Sondazhi i opinionit ofron një perspektivë plotësuese nga poshtë lart për rëndësinë e marrëdhënieve ndëretnike për qytetarët, për atë se sa ata u besojnë medias, dhe sa aktorëve politikë, dhe si ata e perceptojnë ndikimin e narrativave politike dhe mediatike në pajtim.

Bazuar në këto katër drejtime, dokumenti përfundon me një varg rekomandimesh të fokusuara të politikave për institucionet politike, aktorët e mediave, përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe partnerët ndërkombëtarë, që synojnë promovimin e komunikimit publik të përgjegjshëm dhe gjithëpërfshirës, forcimin e raportimit profesional dhe dygjuhësh nga terreni dhe mbështetjen e nismave ndëretnike që i përgjigjen kërkesës së shprehur të qytetarëve për marrëdhënie ndëretnike më konstruktive në Kosovë.

1. Narrativat e Liderëve Politikë dhe Marrëdhëniet Ndëretnike

Hyrje

Ky seksion analizon si diskursi i elitës politike formëson marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë duke kombinuar intervista gjysmë të strukturuara me liderë të partive kryesore politike,[1] Bernard Nikën (PDK), Lutfi Hazirin (LDK), Ardijan Gjinin (AAK) dhe Nenad Rašićin (Ministrin për Kthime), që janë zhvilluar midis prillit dhe gushtit 2025, së bashku me një analizë sistematike të postimeve të partive në Facebook nga shtatori 2022 deri në tetor 2024. Ky i trajton katër pyetje të ndërlidhura, përkatësisht ato se si këta udhëheqës e vlerësojnë "temperaturën" aktuale të marrëdhënieve ndëretnike, si retorika politike ndikon në perceptimet publike dhe perspektivat për pajtim, cilat instrumente politike i konsiderojnë të rëndësishme për përmirësimin e marrëdhënieve dhe si mund të riformulohen narrativat politike dhe mediatike për të rindërtuar besimin midis komuniteteve.

Metodologjikisht, studimi rindërton kornizat e udhëheqësve nga intervistat e tyre, dhe zbaton një kodim të bazuar në rregulla të përmbajtjes së mediave sociale për t'i vendosur tonet pajtuese, të ashpra ose të përqendruara në siguri, ato stigmatizuese dhe neutrale. Pohimi kryesor që del nga të dy rrjedhat e dëshmive është se diskursi i përcakton stimujt, në kuptimin që mesazhet e linjës së ashpër të nxitura nga incidentet mund të mbingarkojnë dialogun, ndërsa kontakti i normalizuar dhe garancitë konkrete zgjerojnë hapësirën për bashkëjetesë.

- **Gjendja e Marrëdhënieve Ndëretnike**

Të katër udhëheqësit politikë të intervistuar pajtohen se marrëdhëniet ndëretnike janë përkeqësuar, edhe pse ata theksojnë faktorë të ndryshëm nxitës. Nikaj thekson rënien në nivel sistemik në marrëdhëniet e shumëfishta me komunitetet jo-shumicë dhe një mosbesim në rritje midis niveleve qendrore dhe lokale. Haziri vlerësimin e vet e bazon në mosangazhimin e komunitetit serb, të nxitur nga bojkoti (veçanërisht në veri) dhe në instrumentalizimin e komuniteteve të tjera jo-shumicë. Gjini paralajmëron për renditjen e ligjshmërisë shtrënguese përpara dialogut social. Rašići thekson rolin e elitave politike në futjen e pykave, që e tejkalon bashkëjetesën më pragmatike të qytetarëve.

Në këtë kontekst, Nikaj argumenton se marrëdhëniet ndëretnike janë në pikën e tyre më të ulët që nga viti 1999, dhe veçanërisht që nga viti 2008, dhe se ky përkeqësim shtrihet përtej marrëdhënieve shqiptaro-serbe në lidhjet midis shumicës shqiptare dhe shumicës së komuniteteve jo-shumicë. Ai këtë trend e lidh me dinamikën parlamentare, dhe posaçërisht me vështirësitë në formimin e shumicës me partitë jo-shumicë, dhe me retorikën e partisë qeverisëse, për të cilën ai pohon se i ka armiqësuar ish-partnerët. Ai shton se edhe në komunat me shumicë serbe në jug të Ibrit, kryetarët e komunave e shohin si "të pamundur" të takohen

[1] Ekipi hulumtues i KIPRED-it kontaktoi z. Glauk Konjufcën, nënkryetar i VV-së, dhe z. Dalibor Jevtićin, nënkryetar i Listës Serbe, për të kërkuar intervista, por nga ta nuk mori asnjë përgjigje.

me zyrtarë të qeverisë qendrore, gjë që është një tregues i besimit të degraduar ndërinstitucional – ndërsa tensionet në veri rrezikun e rrisin edhe më tutje.

Haziri marrëdhëniet ndëretnike i ndan në dy drejtime. Në mesin e përfaqësuesve politikë dhe qytetarë të komuniteteve serbe, dhe posaçërisht në veri, ai sheh bojkotim, "marrëdhënie të kufizuara," dhe një mungesë pothuajse të plotë të bashkëpunimit me Qeverinë e Kosovës. Në mesin e komuniteteve të tjera joshumicë, përveç serbëve, ai vëren instrumentalizim të thellë për qëllime të përditshme politike, duke prodhuar përfaqësim të fragmentuar dhe të tensionuar në vend të integrimit të qëndrueshëm. Ai gjithashtu gjurmon dy faza të bojkotimit politik serb, e para menjëherë pas pavarësisë dhe e dyta në vitet e fundit, dhe argumenton se që të dyjat ishin gabime që penguan përfaqësimin legjitim.

Gjini e thekson një ndarje strukturale, në të cilën komunitetet joshumicë, pos serbëve, në përgjithësi kanë lëvizur drejt integrimit, ndërsa komunitetet serbe i kanë rezistuar kësaj duke i mbajtur gjallë shpresat për ndryshimin e ardhshëm të kufijve. Ai argumenton se klasa politike e Kosovës gjatë një periudhe e toleroi këtë qëndrim, duke pritur që një qasje më e butë përfundimisht do t'i integronte serbët. Sipas tij, pesë vitet e fundit kanë sjellë një zhvendosje drejt një qasjeje të trajtës "ligji para dialogut," për të cilën ai beson se e rrit antagonizmin dhe se nuk ka gjasa të rezultojë në integrim të qëndrueshëm.

Rašići e tërheq dallimin midis qytetarëve dhe politikanëve: bashkëpunimi i përditshëm midis qytetarëve ekziston, por aktorët politikë marrëdhëniet i tërheqin vazhdimisht prapa – "një hap përpara, dy hapa prapa" – përmes narrativave negative dhe jo-pajtuese, dhe posaçërisht në marrëdhëniet shqiptaro-serbe.

Të marra së bashku, të katër intervistat tregojnë se ftohja e marrëdhënieve ndëretnike buron më pak nga ndonjë armiqësi e thellë shoqërore, sesa nga diskursi i elitave politike, i cili vazhdimisht e gërryen besimin. Kjo gërryerje bashkëpunimin e lë të brishtë dhe komunitetet të cenueshme ndaj tronditjeve rastësore. Në fund të fundit, trajektorja formësohet më pak nga ekzistenca e dallimeve, sesa nga mënyra se si udhëheqësit i përcaktojnë ato, pavarësisht nga ajo se a do të angazhohen, dhe kur do të angazhohen, në to, dhe cilat narrativa media i ngrit si reprezentative.

- **Retorika e Elitës Politike dhe Trajtësimi i Perceptimeve Ndëretnike**

Udhëheqësit politikë të intervistuar identifikojnë katër korniza të dallueshme narrative që formësojnë marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë: (1) ngushtimi dhe tëhuajsimi narrativ; (2) narrativat kryesore që formojnë komunitetet jo-shumicë; (3) pasiguria e identitetit dhe gërryerja e solidaritetit; dhe (4) motivimet e përshkallëzimit dhe ashpërsia performuese.

Lidhur me këtë, Nikaj rënien aktuale e lidh me një diskurs udhëheqës që stigmatizon bashkëbiseduesit dhe normalizon mosangazhimin. Sipas tij, kur udhëheqësit e lartë shmangin takimet me homologët serbë apo edhe me shoqërinë civile serbe, kjo sinjalizon se dialogu ndërkomunal është jonormal apo edhe i paligjshëm. Si pasojë, ky perceptim përhapet në

qeverisjen vendore, ku bashkëpunimi praktik ngec. Ai gjithashtu paralajmëron se dështimi për të ndërtuar dialog të brendshëm ndëretnik ia lëshon megafonin narrativave konkurrente, e të cilat më pas "i lëshojnë rrënjët e veta."

Haziri gjurmon se si qeveritë e njëpasnjëshme bashkëpunimin ose mosbashkëpunimin me komunitetet jo-shumicë e kanë strukturuar në mënyra të ndryshme. Qasja e LDK-së pas luftës theksoi përfaqësimin e rezervuar dhe bashkëpunimin e drejtpërdrejtë me aktorët e komunitetit, përfshirë Kishën Ortodokse Serbe, për të siguruar legjitimitet. PDK-ja favorizoi përfshirjen përmes ofertave dhe marrëveshjeve të centralizuara. Për dallim nga kjo, ai argumenton se partia aktuale në pushtet, VV-ja, ka kultivuar një narrativë të sigurimuar ndaj serbëve, duke ngushtuar kështu hapësirën konsensuale për pajtim.

Nga ana tjetër, Gjini argumenton se kur diskursi publik i shumicës nxjerr në pah si kornizë kryesore identitetin kombëtar ("ne jemi shqiptarë"), atëherë komunitetet jo-shumicë reagojnë duke forcuar identitetet e tyre etno-kombëtare, duke e degraduar në këtë mënyrë identitetin e përbashkët shtetëror, dhe duke e rrënuar solidaritetin e nevojshëm për ndërtimin e shtetit.

Rašići vëren se në tregun mediatik ballkanik, gjuha radikale, dhe madje edhe shoviniste, ia kalon asaj të maturisë, meqë klikimet dhe sensacionalizmi i lënë pas rrëfimet "më të lehta" të bashkëjetesës. Kjo dinamikë i nxit politikanët që njëri-tjetrin ta tejkalojnë me retorikë të ashpër, e shtrembëron perceptimin publik dhe i shtyp kornizat biseduese pajtuese.

Si përmbledhje, intervistat tregojnë se kur udhëheqësit stigmatizojnë homologët dhe injorojnë bashkëpunimin, ata publikut i tregojnë se dialogu është jonormal. Si pasojë, bashkëpunimi më pastaj zbehet nëpër nivelet e qeverisjes, duke rezultuar me një boshllëk të cilin më pas e mbushin narrativat konkurrente të linjës së ashpër. Për më tepër, mesazhet që vënë në plan të parë identitetin sjellin "pasqyrën e ashpërsimit" midis komuniteteve jo-shumicë, duke e dobësuar në këtë mënyrë një kornizë të përbashkët qytetare, ndërkohë që mediat që shpërblejnë sensacionalizmin i amplifikojnë pikërisht sinjalet më polarizuese.

- **Shtigjet e Politikave për Përmirësimin e Marrëdhënieve Ndëretnike**

Udhëheqësit politikë të intervistuar identifikojnë katër qasje plotësuese të politikave për të përmirësuar marrëdhëniet ndëretnike: (1) normalizimin e dialogut dhe kontakteve në nivelin e elitave; (2) ofrimin e garancive të strukturuara dhe përfshirjes praktike; (3) vënien e dialogut në vend të parë, me ligjshmërinë në shërbim të besimit; dhe (4) dhënien e përparësisë qasjes "qytetarët të parët," me politikanët në një rol mbështetës.

Në këtë sfond, Nikaj bën thirrje për rinormalizimin e diskutimeve midis aktorëve politikë shqiptarë dhe serbë në nivelet më të larta, ashtu që takimet e tilla të mos jenë "të çuditshme" edhe më tutje. Ai këtë e lidh me rikthimin e temave jo-zgjedhore, por që kanë pasoja, nga dialogu me Serbinë, e deri në një koalicion narrativ më të gjerë, në të tërë shoqërinë, që përfshin shoqërinë civile dhe median. Nikaj po ashtu thekson koordinimin me aktorët ndërkombëtarë,

duke paralajmëruar se politikat e gabuara ose të perceptuara si shtrënguese ndaj komuniteteve serbe ftojnë narrativat ekstremiste për ta mbushur boshllëkun.

Thelbi i politikës së Hazirit është dialogu si "i vetmi instrument," i mbështetur nga garancitë kushtetuese të përfaqësimit në të gjitha nivelet, të drejtat gjuhësore dhe harmonizimi i kurrikulës i zhvilluar me përfaqësuesit serbë, për ta ndërtuar një ndjenjë të ruajtjes së identitetit dhe sigurisë. Ai po ashtu thekson se shteti duhet ta heqë diskriminimin real dhe të perceptuar, të kultivojë besimin dhe të shmangë instrumentalizimin e komuniteteve jo-shumicë për qëllime politike të përditshme. Në këtë drejtim, ai thekson bashkëpunimin ndërkomunal në juglindje, në të gjitha komunat me shumicë serbe dhe me shumicë shqiptare, si dëshmi se bashkëpunimi teknik mund të jetë rutinë dhe pa tendosje kur të depolitizohet dhe përqendrohet në shërbime të përbashkëta.

Rašići argumenton se radhitja e zakonshme duhet të anasjellet, ku udhëheqjen duhet ta marrin të ashtuquajturat histori të lehta nga jeta e përditshme, për shembull projektet shumëetnike dhe nismat e përbashkëta ekonomike, ndërkohë që politikanët do të përqendrohen në sigurimin e infrastrukturës dhe të buxheteve, në vend se të kërkojnë dukshmëri dhe promovim. Sipas tij, bashkëpunimi ekonomik është sektori më premtues për avancimin e interesave të përbashkëta, dhe përfaqësimi proporcional i anëtarëve të komuniteteve joshqiptare në administratë do të krijonte një kuadër të aftë për të formësuar institucionet nga brenda. Ai thekson se qytetarët tashmë bashkëpunojnë më shumë sesa që lejojnë politikanët, kështu që politika publike duhet t'i heqë barrierat e krijuara në nivelin e elitës dhe t'i amplifikojë sukseset që tashmë ekzistojnë midis qytetarëve.

Të marra së bashku, këto propozime e përvijojnë një rrugë koherente dhe të renditur drejt marrëdhënieve më të forta ndëretnike. Së pari, kontakti i elitës duhet të normalizohet ashtu që të motivimet të rivendosen nga e para dhe dialogu të bëhet një rutinë dhe jo një praktikë e jashtëzakonshme. Së dyti, garancitë kushtetuese dhe praktike, të tilla si përfaqësimi, të drejtat gjuhësore dhe bashkëpunimi në përgatitjen e kurrikulave, duhet të sigurohen në mënyrë që përfshirja të bëhet konkrete, dhe jo retorike. Së treti, dialogu duhet t'i paraprijë zbatimit të ligjit, ku ligjshmëria duhet të përdoret për ta konsoliduar besimin, dhe jo për ta zëvendësuar atë. Së fundmi, duhet të dalin në plan të parë historitë nga jeta e përditshme e qytetarëve, dhe posaçërisht nismat e përbashkëta ekonomike, ndërsa politikanët përqendrohen në sigurimin e infrastrukturës dhe buxheteve të nevojshme. Nëse këto propozime ndiqen së bashku dhe koordinohen me partnerët ndërkombëtarë, ky kombinim mund ta shndërrojë bashkëpunimin rastësor në një praktikë të qëndrueshme, ta zvogëlojë hapësirën për narrativa të vijës së ashpër dhe ta ndërtojë rezistencën ndaj tronditjeve të ardhshme.

- **Analizat e Postimeve në Mediat Shoqërore**

Për qëllimet e këtij studimi, KIPRED-i e mblodhi një përmbledhje postimesh në Facebook, të publikuara nga VV (Vetëvendosje), PDK, LDK, AAK, Lista Srpska dhe faqja e Nenad Rašićit, midis 1 shtatorit 2022, dhe 31 tetorit 2024. Kjo përmbledhje më pas u filtrua në postimet që i referoheshin në mënyrë eksplicite temave ndëretnike, duke përjashtuar këtu deklaratat mbi

përkujtimet që lidhen me luftën e viteve 1998/1999, duke përdorur një listë kompakte fjalësh kyçe shumëgjuhëshe (shqip/serbisht/anglisht).

E kemi përdorur një leksik të bazuar në rregulla, ashtu që çdo postimi që lidhej me (ndëretnicitetin) t'i caktohej një shenjë e përgjithshme: (i) Pajtues/Dialogu-i-pari (p.sh., *dialog*, *bashkëjetesë*, *të drejta*, *bashkëpunim*), (ii) Vijë e ashpër/Siguria-e-para (p.sh., *kërcënim*, *sulm*, *kriminalitet*, *sanksione*, *incidente*), (iii) Stigmatizues/Tjetërfare (përbuzje të lidhura me ndonjë grup etnik), ose (iv) Neutral/Burokratik (informues/administrativ pa shenja afektive). "Kur janë shfaqur tone të shumta, është caktuar një shenjë e përgjithshme sipas përparësisë: Stigmatizues → Vijë e ashpër → Pajtues → Neutral. Kjo në një mënyrë konservatore e shmang nënvlerësimin e retorikës së dëmshme. Megjithatë, duhen nënvizuar disa kufizime të mëposhtme të kësaj metodologjie. Etiketimi i bazuar në rregulla mund t'i humbasë nuancat, dhe përqindjet e bazuara në mostrat e aktorëve të vegjël janë më pak të qëndrueshme. Prandaj, gjetjet duhet të lexohen si modele tonesh treguese dhe jo si masa përfundimtare të qëllimit."

Përkundrejt këtij sfondi metodologjik, rezultatet janë analizuar më poshtë.

VV (n=101) — Pajtues 5 (4.95%); Vijë e Ashpër/Siguria së Pari 61 (60.39%); Stigmatizim/Tjetërfare 2 (1.98%); Neutral 33 (32.67%). Komunikimi i VV-së është i shtyrë nga incidentet dhe i përqendruar te sovraniteti. Ndërsa mesazhet pajtuese janë të pranishme, ndjekësit janë më shpesh të ekspozuar ndaj një strukturimi të sigurisë/ligjor dhe disa kushteve të tjetërsimit që mund të normalizojnë konfrontimin, pos kur vendet neutrale përdoren qëllimisht për të përcjellë sinjale përfshirëse.

PDK (n=22) — Pajtues 0 (0.0%); Vijë e Ashpër/Siguri 19 (86.3%); Stigmatizues 0 (0.0%); Neutral 3 (13.7%). Mostra e PDK-së është pothuaj monolite në kornizën e saj të sigurisë. Mungesa e përmbajtjes stigmatizuese sugjeron që kjo kornizë e ashpër nuk shoqërohet sistematikisht me fyerje të hapura etnike ose tjetërsim të qartë, por prapëseprapë e përforcon një narrativë të përqendruar në konflikt, në të cilën rreziqet e sigurisë dhe konfrontimet dominojnë axhendën.

LDK (n=19) — Pajtues 0 (0.00%); Vijë e ashpër 15 (78.9%); Stigmatizues 0 (0.0%); Neutral 4 (21.1%). Komunikimi i LDK-së në këtë mostër normalizon një këndvështrim që vë sigurinë në radhë të parë në çështjet ndëretnike. Mungesa e përmbajtjes stigmatizuese tregon se ky kuadër i vijës së ashpër nuk shoqërohet vazhdimisht me fyerje të qarta etnike apo me tëhuajsim të hapur.

AAK (n=27) — Pajtues 8 (29.6%); Vijë e Ashpër 18 (66.6%); Stigmatizues 0 (0.0%); Neutral (3.7%). Me dy të tretat e postimeve të koduara si të vijës së ashpër dhe pothuajse një të tretën si pajtuese, AAK luhatet midis një narrative të vendosur dhe të fokusuar në kërcënim dhe mesazheve që lënë hapësirë për dialog, bashkëjetesë ose deeskalim.

Lista Serbe (n=147) — Pajtuese 0 (0.0%); Vijë e Ashpër 111 (75.5%); Stigmatizuese 11 (7.5%); Neutrale 25 (17.0%); Përmbledhja e Listës Serbe është kryesisht konfrontuese dhe i sigurimuar. Ky diskurs praktikisht nuk lë hapësirë për dialog, kompromis ose zgjidhje të përbashkët të

problemeve. Në vend të kësaj, ky e normalizon një narrativë kërcënimi, konfrontimi dhe pakënaqësie, me anë të stigmatizimit të herëpashershëm të qartë dhe me asnjë investim të dukshëm retorik në pajtim.

Nenad Rašići (n=4) — Pajtues 2 (50.0%); Vija e Ashpër 0 (0.0%); Stigmatizues 0 (0.0%); Neutral 2 (50.0%). Mostra e Nenad Rašićit, edhe pse shumë e vogël (n=4), tregon një diskurs vazhdimisht jo-konfrontues. Me dy artikuj të koduar si Pajtues dhe dy si Neutral, mesazhi i tij luhatet midis promovimit aktiv të dialogut, bashkëjetesës ose de-eskalimit dhe përcjelljes së informacionit në një mënyrë të shkëputur dhe burokratike.

Si përmbledhje, në të gjitha partitë kryesore shqiptare dhe Listën Serbe, komunikimi ndëretnik mbizotërohet nga një kornizë e linjës së ashpër, që vë në plan të parë sigurinë, me përmbajtje minimale pajtuese dhe, në rastin e Listës Serbe, me një shtresë jo të parëndësishme të stigmatizimit të qartë. Mesazhet neutrale janë të pranishme, por kryesisht funksionojnë si një regjistër dytësor dhe jo si një mjet i qëndrueshëm për deeskalimin apo përfshirje. AAK-ja shquhet për kombinimin e një bërthame të fortë të sigurimuar me një fill pajtues relativisht të dukshëm. Brenda këtij peizazhi, Nenad Rašići shfaqet si një përjashtim, mostra e vogël por koherente e të cilit e tregon një stil jo-konfrontues të komunikimit, të orientuar drejt pajtimit dhe teknokratik.

Përfundimi

Dëshmitë nga intervistat e elitës dhe përmbajtja në mediat sociale përmblidhen në një përfundim qendror se në Kosovën bashkëkohore "temperatura" e marrëdhënieve ndëretnike formohet më pak nga ndonjë armiqësi e fiksuar shoqërore dhe më shumë nga mënyra se si elitat politike zgjedhin ta përcaktojnë ndryshimin, ligjshmërinë dhe bashkëpunimin. Udhëheqësit në të gjithë spektrin pranojnë se marrëdhëniet janë përkeqësuar, mirëpo komunikimi i tyre, dhe posaçërisht në mediat sociale, shumë shpesh e amplifikon rrezikun, konfrontimin dhe pakënaqësitë, në vend që ta normalizojë kontaktin dhe zgjidhjen e përbashkët të problemeve.

Intervistat e tregojnë një shkallë të habitshme të konsensusit për diagnozën. Të katër aktorët politikë i përshkruajnë marrëdhëniet ndëretnike si të brishta ose në rënie, por ata i lokalizojnë shtytësit kryesorë në sjelljen e elitës, dhe jo në armiqësitë e përditshme qytetare. Të marra së bashku, këto rrëfime e përshkruajnë një kontekst në të cilin marrëdhëniet ndëretnike janë strukturalisht të cenueshme, jo sepse komunitetet janë në thelb të papajtueshme, por sepse aktorët politikë dërgojnë vazhdimisht sinjale se dialogu është i jashtëzakonshëm, i rrezikshëm ose i paligjshëm.

Kornizat retorike të identifikuara në intervista ndihmojnë në shpjegimin e mënyrës se si riprodhohet kjo cenueshmëri. Praktikat e ngushtimit dhe tëhuajsimit të narrativës, përfshirë këtu stigmatizimin e bashkëbiseduesve dhe shmangien e qëllimshme të kontaktit, dërgojnë mesazhin se angazhimi midis komuniteteve është abnormal. Rrëfimet gjithëpërfshirëse që i përcaktojnë anëtarët e komuniteteve jo-shumicë kryesisht nga aspekti i dobisë së tyre, ose si kërcënime të mundshme, e gërryejnë çdo ndjenjë të përkatësisë së përbashkët. Mesazhet që e vendosin

identitetin përpara qytetarisë ftojnë një ngurtësim të pozicioneve midis grupeve jo-shumicë dhe dobësojnë një kornizë qytetare në të cilën të gjithë qytetarët mund ta njohin veten.

Analiza e mediave sociale e forcon dhe e qartëson këtë pamje. Në VV, PDK, LDK, AAK dhe veçanërisht në Listën Serbe, postimet që trajtojnë në mënyrë eksplicite temat ndëretnike mbizotërohen nga korniza e linjës së ashpër, me sigurinë në vend të parë, ku mesazhet pajtuese e formojnë vetëm një pjesë fare të vogël, ndërsa, në rastin e Listës Serbe, një sasi e dukshme e përmbajtjes është stigmatizuese. VV-ja mbështetet në komunikimin e nxitur nga incidentet dhe të përqendruar te sovraniteti, PDK-ja dhe LDK-ja postojnë në një regjistër pothuajse tërësisht të sigurimuar, dhe Lista Serbe kombinon linjën e ashpër dhe retorikën e hapur të tjetërsimit, kështu që reagimet e ndjekësve janë të ngopura me një axhendë të përqendruar në konflikt. AAK-ja është disi më ambivalente, duke kombinuar një bërthamë të fortë të sigurimimit me një fill dytësor, por të dallueshëm, pajtues. Nenad Rašići shfaqet si një përjashtim, me një mostër të vogël që është kryesisht jo konfrontuese, pajtuese dhe neutrale. Prandaj, analiza sugjeron që riformulimi i sferës publike nuk është vetëm çështje e ndryshimit të fjalëve, por një projekt politik që narrativat e reja të përgjegjshme duhet t'i ankorojë në praktika të besueshme dhe interesa të përbashkëta.

2. Diskurset Politike dhe të Mediave: Shoqëria Civile dhe Marrëdhëniet Ndëretnike

Hyrje

Ky seksion i analizon intervistat gjysmë të strukturuara me pesë udhëheqës të organizatave të shoqërisë civile që punojnë në marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë, Adelina Hasanin nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë – KCSS (14 prill 2025); Bekim Blakajn nga Qendra për të Drejtën Humanitare në Kosovë – HLC (15 prill 2025); Marigona Shabiun nga Nisma Rinore për të Drejtat e Njeriut në Kosovë – YHRC (2 maj 2025); Miodrag Miličevićin nga OJQ-ja Aktiv (5 qershor 2025); dhe Jovana Radosavljevićin nga Nisma e Re Shoqërore – NSI (13 qershor 2025).

Duke u mbështetur vetëm në këto burime parësore, janë hetuar çështjet në vijim: (1) si i formësojnë marrëdhëniet ndëretnike diskurset politike dhe mediatike; (2) sfidat kryesore me të cilat përballet shoqëria civile në punën e pajtimit; (3) si përfshihen gratë dhe të rinjtë në nisma; (4) si përdoren partneritetet, dialogu dhe edukimi qytetar për t'i kundërshtuar narrativat negative; dhe, (5) propozimet e të intervistuarve për politikat qeveritare. Të pesë këto shpjegime konvergojnë në disa tema – dhe posaçërisht në rolin e tepruar të retorikës së elitës dhe të amplifikimit mediatik – ndërkohë që i ofrojnë disa pika të dallueshme të përparësisë që pasqyrojnë misionet organizative, pozicionet e komunitetit dhe përqendrimin gjeografik.

Metodologjikisht, këto intervista merren si dëshmi ekspertësh për mjediset diskursive, kufizimet institucionale dhe praktikat në terren. Prandaj, të gjitha pretendimet kufizohen në atë që del nga intervistat; nuk paraqiten dëshmi të jashtme.

- **Diskurset Politike dhe Mediatike si Shtytës të Klimës Ndëretnike**

Të pesë të intervistuarit identifikojnë retorikën e elitës politike dhe sjelljen e medias si përcaktues kritikë të marrëdhënieve ndëretnike. Hasani e karakterizon gjuhën mbizotëruese si "toksike," duke argumentuar se udhëheqësit e partive dhe mediat shpesh i japin më shumë përparësi vëmendjes dhe përfitimit politik se sa kohezionit shoqëror, nganjëherë duke përgjithësuar për të gjithë komunitetin serb, dhe posaçërisht pas incidenteve të sigurisë, duke nxitur kështu mosbesimin.

Miličevići i dënon po ashtu tonet "e ashpra" dhe ndonjëherë fyese nga partitë në pushtet, si në anën shqiptare ashtu edhe në atë serbe, me mediat që i transmetojnë dhe rrisin deklaratat e tilla. Ai u bën thirrje redaktorëve që pretendimet e ndezshme t'i kundërshtojnë në vend që ato t'i transmetojnë në mënyrë jokritike.

Në këtë drejtim, Blakaj ofron një ilustrim të gjallë historik, përkatësisht faktin që raportimi sensacional dhe i pasaktë gjatë trazirave të marsit 2004 kontribuoi në përshkallëzimin e shpejtë, duke demonstruar se si media dhe deklaratat zyrtare mund t'i ashpërsojnë qëndrimet dhe të shkaktojnë dinamika të konfliktit ndërkomunitar.

Nga ana tjetër, sipas formulimit që e jep Radosavljević, elitat janë ato që "e përcaktojnë skenën," dhe narrativat stigmatizuese të partisë qeverisëse gjatë disa viteve të fundit kanë thelluar përçarjen midis komuniteteve dhe kanë gërryer besimin e komuniteteve joshumicë në institucione. Duke u përqendruar në periudhën që nga viti 2021, ajo argumenton se elitat përcaktojnë "tonin" e jetës publike, dhe se narrativat stigmatizuese për njërin grup i thellojnë përçarjet shoqërore. Për më tepër, nga këndvështrimi i shoqërisë civile serbe të Kosovës, Radosavljević e shton një shtresë kritike: mediat kryesore në Prishtina shpesh raportojnë për ngjarjet në Veri vetëm përmes kornizave të komunitetit shumicë, duke mos kërkuar fare zëra serb në këtë rast. Kjo prodhon narrativa të acaruara dhe dyluftuese; shqetësimet e ngritura nga serbët në mënyrë refleksive etiketohen si propagandë e drejtuar nga Beogradi, gjë kjo e cila i diskrediton aktorët lokalë dhe shemb terrenin e mesëm.

Shabiu, nga ana tjetër, shpjegon se si diskursi politik dhe logjika e medias ndërthuren, në kuptimin që politikanët, për t'i transmetuar mesazhet e tyre, varen nga mediat, përfshirë këtu edhe platformat sociale, ndërkohë që mediat që përballen me presionet konkurruese shpërblejnë sensacionalizmin, ndërsa aktorët e jashtëm këto kanale i shfrytëzojnë për të përhapur dezinformim, përfshirë këtu edhe të ashtuquajturat "deep fakes" që narrativat me ngjyrime të urrejtjes i mbartin në të dyja ekosistemet e informacionit. Rezultati është një mjedis me rrezik të lartë në të cilin historitë polarizuese i lënë mënjanë nuancat. Ajo po ashtu vëren një realitet të nënvlerësuar, se në disa pjesë të Kosovës, komunitetet me shumicë serbe janë të angazhuara në një integrim më të thellë të përditshëm dhe aktivitet më të madh të përbashkët ekonomik sesa që e pranon narrativa mbizotëruese, por, megjithatë, historitë pozitive marrin më pak mbulim.

Një aspekt tjetër i diskursit ka të bëjë me përgjegjësinë. Të intervistuarit këmbëngulin se institucionet, dhe jo vetëm media, u detyrohen qytetarëve llogaridhënie për gjuhën e zgjedhur. Në këtë drejtim, Radosavljević argumenton se institucionet përkatëse duhet t'i sanksionojnë deklaratat diskriminuese dhe se qeveria duhet ta modelojë një retorikë gjithëpërfshirëse. Pa një veprim të tillë, biseda përjashtuese bëhet shoqërisht e pranueshme dhe e normalizon edhe më tutje përçarjen. Milićević po ashtu pohon se prioritet kryesor është ndryshimi narrativ nga autoritetet politike, pasi që pa të ndikimi i shoqërisë civile e arrin një kufi të sipërm të vendosur nga sjellja e ekzekutivit.

Si përmbledhje, të pesë të intervistuarit pajtohen me një diagnozë të përbashkët se retorika e elitës dhe dinamika e mediave formësojnë në mënyrë vendimtare marrëdhëniet ndëretnike, me diskursin stigmatizues, sensacional dhe të strukturuar kah siguria, që i lënë mënjanë nuancat dhe besimin, dhe ndonjëherë edhe me pasoja përshkallëzuese si në marsin e vitit 2004. Partitë qeverisëse krijojnë skenën dhe kur narrativat e tyre i paraqesin serbët si të tjerë, ndërsa mediat kryesore injorojnë zërat serb, jehonat e polarizuara ngurtësohen, dhe aktorët lokalë diskreditohen. Një logjikë mediatike e orientuar drejt fitimit, e amplifikuar nga platformat sociale dhe dezinformimi i jashtëm, duke përfshirë këtu edhe lajmet e rreme, privilegjon edhe më tutje përmbajtjen nxitëse, ndërsa bashkëpunimi pozitiv dhe i përditshëm mbulohet fare pak. Prandaj, të intervistuarit theksojnë përgjegjësinë institucionale për të sanksionuar fjalimin diskriminues

dhe për të modeluar gjuhën gjithëpërfshirëse, dhe argumentojnë se pa ndryshim narrativ nga lart, ndikimi i shoqërisë civile mbetet i kufizuar.

- **Sfidat Kryesore me të cilat Përballet Shoqëria Civile në Pajtim**

Intervistat shpalosin një mjedis të vështirë për veprim për organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të) që punojnë rreth pajtimit. Dallohen katër grupe sfidash.

(a) Delegjitimimi i politizuar dhe etiketimi i sigurimuar: Hasani argumenton se organizatat e shoqërisë civile që mbështesin dialogun shpesh herë damkosen si bashkëpunëtore të Serbisë, një damkë kjo që gjithashtu i dekurajon aktivistët individualë. Kjo formë e delegjitimimit ndërtimin e urave e paraqet si një lloj tradhtie dhe i rrit rreziqet dhe kostot sociale të angazhimit. Blakaj përshkruan përpjekjet afatgjata të OJQ-ve për të bashkëpunuar përmes komuniteteve, por vëren se retorika shtetërore përjashtuese e kohëve të fundit si dhe politikat jo-përfshirëse kanë bërë që shumë OJQ serbe të tërhiqen. Pos armiqësisë së hapur, ai e thekson një pengesë më të qetë në formën e injorimit nga institucionet dhe nga shoqëria, i cil i gërryen motivimet për të mbështetur punën e ndërtimit të urave.

(b) Narrativat kryesore konkurruese dhe e kaluara e pazgjidhur: Blakaj vëren se narrativat e luftës të viteve 1990 janë diametralisht të kundërta dhe përforcohen nga materiale shkollore të njëanshme dhe të pasakta, të cilat bllokojnë njohjen e vuajtjeve të njëri-tjetrit dhe minojnë besimin. Në mënyrë të ngjashme, Hasani argumenton se trashëgimia e dhunës që nuk është trajtuar mjaftueshëm krijon një boshllëk që e shfrytëzojnë sipërmarrësit politikë dhe aktorët e dezinformimit.

(c) Tkurrja e hapësirës qytetare dhe frikësimi: Shabiu argumenton se veprimet e njëanshme të qeverisë dhe një atmosferë sigurie në përkeqësim e sipër e kanë dëmtuar besimin që OJQ-të e kanë ndërtuan me vite, dhe se shumë pjesëmarrës tani ndihen të pasigurtë duke marrë pjesë në aktivitete të përbashkëta. Radosavljević përshkruan një klimë në përkeqësim që nga viti 2021, të shënuar nga polarizimi, presioni mbi kritikët e pavarur dhe episodet e fushatave të shpifjes ose sulmeve, të cilat së bashku punën e pajtimit e bëjnë më të rrezikshme dhe më kërkuese sa i përket resurseve. Në një mënyrë të ngjashme, Milićevići e sjell në mendje një ndjesi përpjekjesh sizifiane, pasi përparimi mund të zhbëhet nga një shpërthim i retorikës nxitëse nga ana e elitave politike, duke i detyruar organizatat të fillojnë nga e para për të riparuar lidhjet e prishura.

(d) Brishtësia e financimit dhe mospërputhja e donatorëve: Si Milićević ashtu edhe Radosavljević e nënvizojnë pasigurinë financiare. Milićević paralajmëron se axhendat e donatorëve nuk përputhen gjithmonë me nevojat në terren, duke e ndërlikuar kështu vazhdimësinë në ndërtimin e besimit afatgjatë. Radosavljević shton se paqëndrueshmëria në të gjithë sektorin rrezikon vetë aftësinë e OSHC-ve për të vazhduar si aktorë të pavarur. Hasani vëren ndryshime më të gjera gjeopolitike që mund të zvogëlojnë mbështetjen pikërisht për llojet e platformave ndërkomunitare që janë më të nevojshmet.

Si përmbledhje, intervistat përshkruajnë një shoqëri civile veprimi i Të cilës përballet me erëra të fuqishme që fryjnë kundër saj. Ndërtuesit e urave stigmatizohen si bashkëpunëtorë, narrativat konkurruese të luftës dhe kurrikulat e njëanshme bllokojnë njohjen reciproke, dhe hapësira qytetare e ngushtuar që nga viti 2021, është normalizuar me presionin, fushatat e shpifjes dhe zmbrapsjet periodike që përfitimet e saj mund t'i fshijnë brenda natës. Brishtësia financiare dhe mos-rreshtimi i donatorëve e dëmtojnë më tutje vazhdimësinë në ndërtimin e besimit afatgjatë, ndërsa ndryshimet gjeopolitike kërcënojnë mbështetjen për platformat ndërkomunitare. Përtej këtyre kufizimeve ekziston një fill i përbashkët i asimetrisë së ndikimit, në të cilin OSHC-të mund ta ushqejnë dialogun dhe mikrobesimin, por përparimi i tyre mbetet tejet i lëndueshëm nga goditjet e politizuara të cilat nuk mund t'i kontrollojnë.

- **Kundërshtimi i Narrativave Negative: Partneritetet, Dialogu dhe Edukimi Qytetar**

Bazuar në intervistat me udhëheqësit e shoqërisë civile, ky nënseksion shqyrton si përdoren partneritetet ndëretnike, platformat e dialogut dhe edukimi qytetar për t'i luftuar narrativat e dëmshme. Ky i nxjerr në pah taktikat praktike si bashkëpunimin mediatik, demaskimin e synuar dhe rrëfimin e historive që bashkëjetesën e përditshme e paraqesin si normale.

(a) Koalicionet dhe platformat ndëretnike: Blakaj rrëfen për angazhimin e Kosovës dhe të rajonit në nismën afatgjatë RECOM/KOMRA, ku shoqatat e viktimave dhe të rinjtë e të gjitha komuniteteve krijuan empati dhe "normalizuan" komunikimin madje edhe kur shtetet refuzuan të institucionalizonin një komision të përbashkët të së vërtetës. Milićević e thekson Alternativën Qytetare të Kosovës – një përpjekje e përbashkët kjo nga organizatat serbe dhe shqiptare dhe aktorët e pavarur për të kundërshtuar narrativat e dëmshme dhe për të avokuar kolektivisht ndaj qeverisë dhe palëve të interesuara ndërkombëtare. Radosavljević e thekson ndërtimin e rrjetit dhe avokimin e përbashkët me OSHC-të me bazë në Prishtinë, të kombinuar me shtrirjen e vëmendjes tek partnerët ndërkombëtarë kur angazhimi i qeverisë ngec.

(b) Edukimi qytetar dhe pedagogjia publike: Organizata e Blakajt ka ndjekur edukimin joformal mbi drejtësinë tranzicionale në shkollat e mesme për më shumë se një dekadë, duke synuar të fusë përmbajtje të balancuar në kurrikula dhe të thyejë monopolin e narrativave kryesore antagoniste. Ndërsa Radosavljević vëren ndarjen sistemike midis sistemeve arsimore, ajo thekson fuqinë formuese të familjes, të rretheve shoqërore dhe të mediave të reja, duke e bërë edukimin në nivel komuniteti dhe shkrim-leximin mediatik qendror për punën e kundër-narrativës.

(c) "Demistifikimi" dhe partneritetet mediatike: Organizata e Hasanit prodhon raportime analitike për të çmitizuar dezinformimin, dhe posaçërisht narrativat që i shënjestrojnë komunitetet serbe në gjuhën serbe, dhe kjo bashkëpunon me OSHC-të serbe për ta rritur besueshmërinë dhe shtrirjen e vet. Ajo po ashtu argumenton për aleanca më të forta OJQ-media, për të nxjerrë në pah historitë e bashkëjetesës dhe për të depërtuar në hapësirat e informacionit në gjuhën serbe ku qarkullon dezinformimi që ngjall frikë. Milićevići nënvizon potencialin e parealizuar të bashkëpunimit OSHC-media. Ai argumenton se ndërsa mediat kanë shtrirje

pakrahasueshëm më të madhe se OSHC-të , këto të fundit mund të ofrojnë korniza të balancuara dhe parimore; së bashku ato zhurmën e elitës mund ta transformojnë në llogaridhënie publike.

(d) Rrëfimi i historive dhe normalizimi i përditshëm: Radosavljević përshkruan dy nisma: një platformë për ndërtimin e besimit që mbledh histori pozitive ndërkomunitare që përndryshe mungojnë në titujt kryesorë të lajmeve, dhe Oči u oči ("Sy më Sy"), e cila punoi me influencues të rinj për t'i përshkruar aktivitete të zakonshme dhe të përziera në të tërë Kosovën – akte të vogla këto, por konkrete, që në një mënyrë delikate mund ta rihumanizojnë "tjetrin."

Si përmbledhje, intervistat përshkruajnë një qasje pragmatike kundër-narrativë në të cilën koalicionet ndëretnike zgjerojnë hapësirën për kontakt, dhe edukimi qytetar afatgjatë dhe njohuritë mediatike gradualisht i dobësojnë narrativat kryesore antagoniste, dhe ku partneritetet e OJQ-ve dhe të mediave punojnë së bashku për ta demaskuar dhe riformuluar përmbajtjen në hapësirat e informacionit në gjuhën serbe dhe shqipe. Rrëfimi që nxjerr në pah bashkëjetesën e përditshme përvojat e tilla i bën të dukshme, dhe këto përpjekje së bashku ndihmojnë që mikro-besimin e shkapërderdhur ta shndërrojnë në një ndikim më të gjerë publik, me kusht që bashkëpunimi të jetë i qëndrueshëm dhe shtrirja të zgjerohet në të gjitha audiencat e segmentuara.

- **Propozimet Qeverisë**

Duke u bazuar në intervista, ky seksion i përshkruan hapat praktikë për qeverinë për ta shtensionuar retorikën, për ta zgjeruar përfshirjen dhe për të rindërtuar besimin ndëretnik, që e mundëson dhe siguron në këtë mënyrë një hapësirë qytetare që e mundëson kalimin drejt bashkëjetesës dhe që atë e bën të qëndrueshëm.

(a) Diskurs zyrtar i përgjegjshëm dhe gjithëpërfshirës: Blakaj i kërkon qeverisë ta përvetësojë një ton më të moderuar, gjithëpërfshirës, dhe të bazuar në fakte, për ta shmangur paraqitjen e vetëm njërës anë, dhe për t'i pranuar krimet dhe viktimat në të gjitha komunitetet, si për të dhënë shembull të qytetërimit ashtu edhe për t'i lënë kornizat polarizuese pa oksigjen. Radosavljević në mënyrë të ngjashme u bën thirrje vendimmarrësve të veprojnë me përgjegjësi dhe të sanksionojnë deklaratat diskriminuese, duke theksuar se zyrtarët e lartë duhet të përfaqësojnë dhe t'u drejtohen të gjithë qytetarëve, duke përfshirë përdorimin e gjuhës serbe kur komunikojnë për çështje me interes publik. Milićevići argumenton se ndryshimi më i rëndësishëm është ndryshimi i narrativës. Ai thekson se udhëheqësit duhet të ndalojnë shpifjen e ndërsjellë, të sinjalizojnë qartë se serbët janë të mirëseardhur në Kosovë dhe t'i përputhin këto mesazhe me politika që mbrojnë të drejtat dhe dinjitetin e përditshëm.

(b) Angazhimi i qytetarëve serbë në një "dialog të brendshëm" të mirëfilltë: Shabiu rekomandon përfshirjen e strukturuar të komuniteteve lokale serbe në proceset e dialogut të brendshëm dhe paralajmëron kundër masave të njëanshme të "integrimit të detyruar" (p.sh., mbylljet e përnjëhershme të institucioneve paralele) që simbolikisht mund të duken të forta, por e gërryejnë besimin dhe bashkëpunimin e ardhshëm e bëjnë më të kushtueshëm.

(c). Barazia gjuhësore dhe qasja në informacion: Rekomandimi më konkret institucional i Hasanit është dygjuhësia sistematike, që do të thotë se të gjitha lajmet zyrtare dhe postimet publike duhet të shfaqen si në shqip ashtu edhe në serbisht, gjë që qytetarëve serbë do t'u mundësonte ta verifikonin informacionin dhe ta zvogëlonin ndjeshmërinë ndaj thashethemeve dhe dezinformimit të bazuar në frikë. Milićevići shkon më tutje duke theksuar shkeljet e vazhdueshme të të drejtave gjuhësore në nivelin institucional dhe duke argumentuar se zbatimi i vazhdueshëm është parakusht themelor për rindërtimin e besimit.

(d) Partneriteti me shoqërinë civile dhe angazhimi dypalësh: Hasani thekson bashkëpunimin e strukturuar midis institucioneve dhe OSHC-ve, përfshirë në veri, dhe nevojën që mediave në gjuhën serbe t'u ofrohet informacion i saktë dhe qetësues në lidhje me qëllimet shtetërore. Ndërkohë që Radosavljević kujton përpjekjet e hershme të pasuksesshme për dialog me qeverinë në largim, ajo ende sheh nevojën për t'i identifikuar partnerët institucionalë që janë të gatshëm pët t'i korrigjuar politikat problematike.

Si përfundim, të intervistuarit bëjnë thirrje për një resetim që do të udhëhiqet nga shteti bazuar në komunikim zyrtar të përgjegjshëm, gjithëpërfshirës dhe dygjuhësh, sanksione për fjalimet diskriminuese dhe një narrativë të qartë se serbët janë të mirëseardhur, me fjalë të mbështetura nga politika që mbrojnë të drejtat. Ata kërkojnë dialog të brendshëm të strukturuar që përfshin komunitetet lokale serbe, shmang masat e njëanshme të integrimit të detyruar dhe siguron zbatim të fortë të barazisë gjuhësore dhe të qasjes në informacion. Të kombinuara me partneritete dypalëshe me shoqërinë civile dhe një prani proaktive në mediat në gjuhën serbe, këta hapa sinjalet politike do t'i shndërronin në garanci të besueshme, do të kufizonin narrativat polarizuese dhe do të siguronin hapësirën qytetare të nevojshme për ta bërë bashkëjetesën më të qëndrueshme.

Përfundimi

Të marra së bashku, intervistat ofrojnë një pamje të qartë shkakësore se diskursi politik dhe mediatik nuk është një zhurmë në prapavijë, por lëvizësi kryesor i klimës ndëretnike në Kosovë. Kur elitat politike mbështeten në korniza ligjore stigmatizuese dhe të orientuara drejt sigurisë, dhe posaçërisht në kohë krize, dinamikat e medias amplifikojnë polarizimin, lënë mënjanë mesazhet pajtuese dhe gërryejnë besimin e komuniteteve joshumicë. Rezultati është një mjedis informativ me rrezik të lartë në të cilin historitë pozitive dhe bashkëpunimi i përditshëm në një mënyrë strukturore raportohen fare pak.

Shoqëria civile vepron në këtë mjedis të vështirë dhe përballet me një asimetri të natyrshme të ndikimit. OSHC-të mund ta ruajnë kontaktin, të kultivojnë besim në mikro-nivel dhe të ndërtojnë kundër-narrativa përmes koalicioneve, edukimit qytetar, demaskimit dhe rrëfimit të historive, mirëpo këto përfitime mbeten të brishta kur hapësira qytetare ngushtohet, delegjitimimi rritet e financimi është i pasigurtë. Mësimi nuk është se puna nga poshtë lart është joefektive, por se ajo është e kushtëzuar, meqë pa sinjale mbështetëse dhe mbrojtje nga shteti dhe media kryesore, përparimi vazhdimisht zhbëhet nga valët e reja të retorikës nxitëse.

Nga propozimet e të intervistuarve del një rrugë koherente, e përqendruar në komunikim zyrtar dygjuhësh të përgjegjshëm, gjithëpërfshirës dhe sistematik, sanksione të dukshme për fjalimet diskriminuese, dialog të brendshëm të strukturuar me komunitetet lokale serbe dhe partneritete të institucionalizuara dypalëshe me shoqërinë civile, duke përfshirë një prani proaktive në sferat mediatike në gjuhën serbe. Këta hapa nuk janë shtesa kozmetike, sepse ata harmonizojnë stimujt, normalizojnë kontaktin dhe krijojnë hapësirë qytetare në të cilën bashkëjetesa mund të bëhet rutinore dhe jo episodike.

Së fundmi, kjo analizë është e kufizuar qëllimisht në dëshmitë parësore, por kjo megjithatë ende e vë në dukje një test praktik suksesi, dhe atë nëse informacioni rutinë që marrin qytetarët, për sa i përket tonit, qasjes në gjuhë, frekuencës së sinjaleve pajtuese dhe përgjegjësisë për fjalimin përjashtues, ndryshon në mënyra që e bëjnë besimin më pak të kthyeshëm.

3. Midis Përmbajtjes dhe Polarizimit: Mjedisi Medial i Kosovës për Marrëdhëniet Ndëretnike

Hyrje

Ky seksion shqyrton se si gazetarët dhe redaktorët nga mediat kryesore në gjuhën shqipe dhe serbe të Kosovës e përshkruajnë mbulimin e tyre të marrëdhënieve ndëretnike, standardet editoriale që e udhëheqin punën e tyre, qasjet e tyre ndaj raportimit të incidenteve dhe menaxhimit të stereotipeve, si dhe presionet dhe kufizimet e resurseve që formësojnë praktikën e redaksisë. Ky më tutje shqyrton se si ata e kuptojnë rolin e medias në pajtim, shkallën e bashkëpunimit përtej ndarjes gjuhësore dhe masat politike që ata vetë i propozojnë për t'i frenuar narrativat e dëmshme në një kontekst të shënuar nga retorika politike polarizuese.

Puna në terren është kryer në periudhën prill-gusht 2025 dhe ka përfshirë të intervistuarit e mëposhtëm: Brikenda Rexhepi (Koha Ditore), Ilir Mirena (Periskopi), Valon Syla (Gazeta Metro), Xhemajl Rexha (Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës - AGK), Arbër Vllahiu (RTV21), Leart Hoxha (ATV), Besnik Tahiri (Klan Kosova), Kushtrim Sadiku (Kanal 10), Rid Berisha (Arbëria TV), Halil Matoshi (gazetar veteran), Leonard Kerquki (Gazeta Express/T7), Darko Dimitrijević (Radio Goraždevac), Mirjana Milutinović (Kontakt Plus), Isak Vorgučić (RTV KiM) dhe Tatjana Lazarević (KoSSev).

Për t'i pasqyruar dhe kontekstualizuar në mënyrë sistematike këto njohuri cilësore, KIPRED-i po ashtu i analizoi narrativat për çështjet ndëretnike të gjashtëmbëdhjetë botimeve mediale, të përbëra nga dymbëdhjetë botime mediale në gjuhën shqipe (RTV21, ATV, Gazeta Express, Indeks Online, KTV, Kallxo.com, Kanal 10/Gazeta 10, Klan Kosova, Kosova Press, Metro, Nacionale dhe Telegrafi) dhe katër botime mediale në gjuhën serbe (KoSSev, RTV KiM, Radio Goraždevac dhe Kosovo Online), të cilat mbulojnë periudhën nga 1 shtatori 2022 deri më 30 tetor 2024.

- **Vlerësimi i Mjedisit Mediatik për Marrëdhëniet Ndëretnike në Kosovë**

Përmes këtyre intervistave, hapësira informative e Kosovës për marrëdhëniet ndëretnike duket e ndarë midis një rryme kryesore, përgjithësisht profesionale, që e shmang nxitjen e hapur, dhe një segmenti të politizuar, që kërkon fitim, dhe i cili identitetin dhe pakënaqësitë i trajton si mallra. Pikat kryesore të defektit lidhen me deficitet gjuhësore, kapacitetin e pabarabartë editorial dhe tërheqjen gravitacionale të politikës së lartë, dhe posaçërisht gjatë krizave në veri.

Disa bashkëbisedues mediat kryesore në gjuhën shqipe i shohin si relativisht të përmbajtura. Rexhepi i konsideron kanalet televizive dhe portalet që ajo i përcjell si kryesisht të sakta dhe profesionale në mbulimin e tensioneve, duke i pasqyruar zhvillimet reale në vend që t'i ndezin ato, ndërkohë që paralajmëron se pjesë të sferës së gjuhës serbe, të ndikuara nga Beogradi, prodhojnë narrativa të paqarta ose të pasakta për audiencat serbe. Mirena bën një dallim të qartë midis mediave kryesore me pronësi të dukshme dhe të ashtuquajturave faqe fantazmë në mediat sociale, dhe të parat i përshkruan si të kujdesshme dhe jo-inflamatore ndaj incidenteve

të ndjeshme, edhe pse një mjedis i vazhdueshëm lajmesh të rreme e kërkon vigjilencën e mësuar që nga viti 2004. Syla gjithashtu thekson efektin disiplinues të donatorëve dhe rregullatorëve, duke vënë në dukje se fyerjet etnike përjashtohen dhe ndëshkohen shpejt, dhe duke kujtuar përdorimin e termit "shka" nga një transmetues që çoi në një dorëheqje brenda një dite. Sipas tij, burimi kryesor i ndezjes janë aktorët politikë që kërkojnë vota nacionaliste, dhe jo gazetarët, ndërsa KFOR-i dhe mbikëqyrja e jashtme shërbejnë si faktorë stabilizues.

Të tjerë i theksojnë pikat e forta të pabalancuara të sistemit. Matoshi pranon një shkallë neutraliteti, por sheh pjesë të ekosistemit që ende ushqehen me nacionalizëm, dhe posaçërisht në veri, ku tjetri mund të shihet lehtësisht si armik. Rexha raportimin ndëretnik e përshkruan si fushën më të ndjeshme dhe vlerëson mediat e mbështetura nga OJQ-të si BIRN dhe Kosovo 2.0 për formatet me burime të shumëfishta që përfshijnë komunitetet joshumicë, ndërsa vëren se rutina e lajmeve të fundit në mediat private mund të rrisë emocionet, posaçërisht midis gazetarëve të rinj me pak kontakt ndërkomunitar gjatë kulmeve të lajmeve si Banjska. Vllahiu sjelljen e redaksisë e lidh me ciklet politike, duke argumentuar se kur marrëdhëniet qetësohen, mbulimi ndëretnik tërhiqet dhe kur tensionet rriten, lajmet tërhiqen në politikën e lartë. Mësimi i marsit 2004 ende peshon shumë, dhe ai pohon se mungesa e një makine të centralizuar propagandistike të tipit serb të viteve 1990 duhet të lejojë që pluralizmi të veprojë si një kundërpeshë demokratike, edhe pse narrativat e vjetra serbe për shqiptarët vazhdojnë të qarkullojnë.

Ndarja midis kujdesit profesional dhe amplifikimit të politizuar shfaqet si një temë e përsëritur. Berisha vëren se mediat serioze përdorin gjuhë të saktë, të deetnizuar dhe dallojnë individët e dyshuar nga komuniteti i gjerë, ndërsa një shtresë paralele e mediave dhe rrjeteve sociale të sponsorizuara nga partia e shndërron identitetin në lëndë djegëse elektorale. Debati publik më pas shembet në gara se kush është më shqiptar, dhe trajtimi i dobët i zhvillimeve në veri rrezikon të forcojë ndikimin e Beogradit dhe të dëmtojë imazhin e jashtëm të Kosovës. Kerquki përshkruan disa faza, duke filluar me kujdesin e ndërtuar përmes trajnimit pas luftës, pastaj ngjarjet e marsit 2004 të cilat nxorën në pah dështimin katastrofik, duke përfshirë një lajm të rremë nga transmetuesi publik, dhe së fundmi periudhën që nga Banjska, në të cilën ai sheh një rritje të diskursit nacionalist, dhe posaçërisht midis gazetarëve të rinj që nuk e përjetuan luftën.

Redaktorët e gjuhës serbe përshkruajnë një strukturë nxitëse armiqësore. Dimitrijević vëren se mediat e lidhura me Beogradin i stigmatizojnë disidentët si tradhtarë ose bashkëpunëtorë të Kurtit, ndërsa pjesë të sferës së gjuhës shqipe i portretizojnë objektivat e tyre si përfaqësues të Listës Serbe ose Beogradit, shpesh pa u dhënë të drejtën e përgjigjes. Demonizimi i figurave të tilla si Oliver Ivanovići tregon se si narrativat mund të shndërrohen në dëm të vërtetë, edhe pse formatet ndërkomunitare si “Ekvitas” dhe “Da te pitam, komšija” mbeten të përdorura fare pak. Milutinović sheh polarizim më të thellë sesa në fillim të viteve 2000, me një lente etnike që bëhet më e mprehtë gjatë krizave në veri dhe redaksi më të vogla serbe që mbështeten më shumë në ripostime sesa në angazhimin e drejtpërdrejtë me institucionet në Prishtinë.

Nga një këndvështrim tjetër, Vorgučić argumenton se mbulimi i komunitetit "tjetër" shtrembëron rrëfimet negative, ndërsa ato pozitive tërheqin reagime armiqësore në internet, duke përforcuar distancën. Për Lazareviqin, problemi është sistemik, pasi ekzistojnë dy ekosisteme paralele mediatike, secili i robëruar nga narrativa e tij kombëtare, të cilat veprojnë në një klimë më të gjerë "post-të vërtetës" ku qendrat politike, jo redaksitë, përcaktojnë axhendën.

- **Politikat Editoriale për Raportimin për Çështjet Ndëretnike**

Në të gjitha intervistat, redaktorët përshkruajnë një model të ngjashëm në të cilin shumica e mediave të Kosovës nuk mbajnë rregulla të veçanta për mbulimin ndëretnik. Në vend të kësaj, ata mbështeten në Kodin Kombëtar të Etikës, duke e zbatuar atë përmes një kontrolli më të fortë editorial, gjuhës së kujdesshme dhe rutinave specifike të raportimit të krizave. Së bashku, këto praktika formojnë një grumbull të përbashkët mjetesh joformale që synon t'i qetësojë storjet që përndryshe mund të nxisin tensionet etnike.

Në KOHA, Rexhepi praktikën e bazon në kriteret themelore të kërkimit të së vërtetës dhe në Kodin e Etikës, i cili tashmë përfshin mbrojtje për komunitetet etnike joshumicë, fëmijët dhe gjininë. Sipas saj, nëse Kodi ekzistues zbatohet me rigorozitet ndonjë manual i veçantë nuk është i nevojshëm. Në mënyrë të ngjashme Mirena thekson se media e tij nuk ka një statut specifik të dedikuar për raportimin ndëretnik, dhe se udhëzimet janë të nënkuptuara por të forta, me theks në verifikimin rigoroz gjatë periudhave të tensionit të lartë, kujdes të veçantë te titujt dhe shmangien e ndezjes së zjarrit duke mbajtur mbulimin të ekuilibruar.

Disa redaktorë përshkruajnë vija të qarta të kuqe në vend të rregulloreve të gjata dhe të detajuara. Syla i referohet memorandumeve të brendshme në mediat kryesore që ndalojnë gjuhën përçmuese etnike, dekurajojnë opinionin e fortë në tekstin e lajmeve dhe kërkojnë që draftet e ndjeshme të rishikohen nga një redaktor përgjegjës i cili kontrollon si cilësinë editoriale ashtu edhe rrezikun ligjor. Ai e krahason këtë kontroll të strukturuar me faqet e paqëndrueshme dhe anonime të Facebook-ut që riemërtojnë imazhin nga një ditë në tjetrën dhe turbullojnë origjinën e informacionit, duke minuar besimin. Për Matoshin, pika kryesore e referencës është ajo që ai e quan barazi kushtetuese, e kuptuar si një formë e patriotizmit kushtetues që hedh poshtë një shumicë kundër komuniteteve jo-shumicë dhe pret që shtypi të ushtrojë vetërregullim, edhe nëse balanca e përgjithshme mbetet e pabarabartë.

Disiplina gjuhësore rezulton të jetë një normë qendrore operative. Rexha vëren se mediat private nuk mbajnë rregullore të posaçme përtej Kodit dhe se baza është drejtësia strikte, e bazuar në fakte, me një parim të panegociueshëm, përkatësisht shmangien e gjuhës që ofendon komunitetin tjetër. Sipas tij, terma të tillë nuk lejohen në mediat në gjuhën shqipe, dhe nëse ndodhin gabime në transmetim, moderatorët pritet të ndërhyjnë dhe të sigurojnë korrigjime në kohë reale. Ai e krahason këtë me mediat e orientuara drejt shtetit serb, ku gjuha përçmuese ndaj shqiptarëve është e rëndomtë dhe formëson audiencën serbe. Ai shton se, krahas praktikës së redaksisë, AGK mbështet trajnimin, duke përfshirë punën me ZFD Forum ProPeace për

raportimin e së kaluarës dhe përdorimin e terminologjisë neutrale dhe të ndjeshme ndaj nivelit lokal.

Rutinat e raportimit të krizave janë gjerësisht të përhapura. Vllahiu standardet e qarta i preferon më shumë se manualet speciale dhe ndjek një etikë të thjeshtë për kohët e tensionit, së pari të mbrohen gazetarët dhe më pas të sigurohet e vërteta nga të gjitha anët, posaçërisht në komunat veriore, në mënyrë që të pasqyrohet situata reale dhe objektive. Ai e sheh një boshllëk në përgatitje dhe argumenton se gazetarët më të rinj kanë nevojë për një trajnim më të shënjestruar, një çështje kjo që doli në pah pas protestave të vitit 2023, sulmit në Banjskë dhe polemikave rreth urës së Mitrovicës. Hoxha po ashtu nënvizon se redaktorët mbështeten në normat e vendosura dhe përdorin raportet e incidenteve policore si një bazë neutrale për mbulimin fillestar. Grackat e zakonshme që ai vëren përfshijnë dështimin për të dalluar midis qytetarëve të Serbisë dhe serbëve të Kosovës dhe një tendencë për t'i mbietnizuar përleshjet e zakonshme, ndërsa ngjarjet e mëdha si Banjska u politizuan në kohën reale, gjë që e bëri raportimin e saktë më të vështirë.

Disiplinat operacionale konvergojnë në deetnizimin dhe standardet e larta të verifikimit. Tahiri thekson dy rregulla, përkatësisht që incidentet nuk duhet të mbi-etnizohen dhe që gazetarët duhet të përdorin gjuhën e parë të shtetësisë, duke përmendur etninë vetëm kur ajo në një mënyrë shkakësore është relevante. Kur janë nën presion, ekipi i tij raporton vetëm atë që ka verifikuar drejtpërdrejt. Për Sadikun, parimet thelbësore janë të thjeshta por të rrepta, për të verifikuar informacionin, për të përfshirë të gjitha palët, për të shmangur amplifikimin e një narrative "ne kundër atyre" dhe për t'i mbikëqyrur titujt nga afër. Formulime të tilla si "një serb bëri X" ose "një shqiptar bëri Y" nuk lejohen, dhe gjuha e urrejtjes mbetet një vijë e kuqe e qartë. Në Arberia TV, Rid Berisha zbaton verifikim të rreptë për të parandaluar etnizimin, me gazetarë me përvojë që hartojnë tekste të thjeshta dhe pa emocione gjatë periudhave të tensionit, dhe me gazetarë më të rinj që marrin trajnim të shënjestruar në mënyrë që ta përvetësojnë të njëjtën përmbajtje. Kerquki e përshkruan qasjen e ekipit të tij si një kombinim të vërtetësisë dhe terminologjisë së disiplinuar, të ngulitur në kulturën e përditshme të redaksisë dhe jo vetëm në manualet e shkruara.

Botimet mediale në gjuhën serbe përshkruajnë ose kode të shtresuara ose regjime të bazuara në praktikë. Dimitrijevići vëren se Radio Goraždevaci vepron sipas një sërë udhëzimesh, duke përfshirë Kodin e Gazetarëve të Kosovës, një kod dhe nënkod të brendshëm, rregullat mbi gjuhën e ndjeshme dhe një kod barazie gjinore, në mënyrë që të mbajë tekstin e saktë dhe të deetnizuar. Milutinovićja shpjegon se Kontakt Plusi ndjek një etos të bazuar në praktikë i cili, për ta parandaluar përshkallëzimin, mbështetet në verifikimin nga burime të shumëfishta, përfshirjen e komuniteteve të ndryshme, shmangien e gjuhës polarizuese dhe deklaratat eksplicite kur incidentet nuk janë ndëretnike. Vorgučići këmbëngul që në KIM të ketë të paktën dy burime, duke ofruar të drejtën e përgjigjes dhe duke marrë konfirmimin e policisë para publikimit, ndërsa gjithashtu nxjerr në pah arritjet pozitive si sporti në mënyrë që të kompensojë paragjykimin strukturor ndaj lajmeve të këqija. Për KoSSev, Lazarević përshkruan një redaksi të vogël të

ankoruar në standardet etike dhe që vepron pothuajse si një ekip gueril, ku nuk ka lajme të padëmshme dhe ku pluralizmi i burimeve trajtohet si ndihma e parë, ndërsa koha dhe konteksti janë të kalibruar me kujdes, veçanërisht kur raportojnë për krimet e luftës kundër shqiptarëve.

- **Presionet e Jashtme mbi Raportimin Ndëretnik: Rreziku i Ambientit, Tkurrja e Mbrojtësve Zbutës**

Përmes të gjitha intervistave, redaktorët përshkruajnë një tranzicion nga censura e hapur në presione të përhapura, të ambientit, që objektivitetin e bëjnë të brishtë, dhe posaçërisht gjatë krizave në Veri. Pasiguria ekonomike, rrjetet militante online, paqartësia institucionale dhe propaganda ndërkufitare kombinohen për të ngushtuar hapësirën për raportim të bazuar në standarde. Shumica e redaksive reagojnë duke shtrënguar verifikimin dhe disiplinën gjuhësore në vend që të përballen hapur me pushtetin.

Për Rexhepin, kufizimet kryesore janë financiare dhe teknologjike, duke përfshirë tkurrjen e mbështetjes së donatorëve, stafin e kufizuar dhe statusin e pasigurtë të mediave në gjuhën serbe që rrezikojnë mbylljen ose varësinë nga reklamat nga qeveria serbe. Ajo sheh më pak presion të drejtpërdrejtë në shoqëri mbi temat ndëretnike sesa në periudhat e mëparshme, por vëren se ndikimi nga Beogradi, frikësimi lokal dhe pritjet e audiencës inkurajojnë vetëcensurën në zonat me shumicë serbe. Mirena thekson një klimë politike armiqësore në të cilën militantët e partive dhe publiku besnik i etiketojnë mediat kritike si pro-serbe ose të financuara nga jashtë. Masat shtrënguese gjatë periudhës së COVID-it e përkeqësuan këtë, ndërsa reklamuesit u tërhoqën, stafi u pushua nga puna dhe kapaciteti hetimor ra. Rreziqet e sigurisë në veri dhe grumbullimet e shpeshta në mediat sociale nxisin kujdesin edhe më tutje.

Disa të intervistuar theksojnë se presioni i drejtpërdrejtë politik për mbulimin etnik është më i lehtë se që ishte para pavarësisë, por se format më të buta të ndikimit tani janë më të shpeshta. Syla e krahason mjedisin e sotëm e krahason me llupën zmadhuese të viteve 1990 dhe argumenton se agjendat e donatorëve dhe rrjetet militante partiake ose fetare, shpesh të koordinuara nga diaspora, tani përdorin mediat sociale si armë. Ai shpjegon se përgjigja editoriale ka qenë mbështetja në verifikimin dhe përmbajtjen e shtuar në vend se t'i amplifikojnë presionet e tilla. Halil Matoshi tregon në kujdestarët nacionalistë brenda institucioneve që stigmatizojnë gazetarët kur rrëfimet e shqetësojnë shumicën, dhe vëren se këto sanksione delikate formësojnë sjelljen e redaksisë në periudha të ndjeshme pa pasur nevojë për ndalime të qarta.

Të tjerë nxjerrin në pah presionet strukturore dhe asimetritë e informacionit. Rexha nuk sheh ndonjë drejtim të jashtëm sistematik të mediave në gjuhën shqipe dhe konsideron se vendimet drejtohen kryesisht nga prioritetet e redaksive dhe qëndrimet më të gjera shoqërore. Sipas tij, penguesi më i madh është kontrolli i qeverisë serbe mbi botimet mediale, i pasuar nga serbët e Kosovës, ku retorika raciste dhe ksenofobe është e zakonshme, e kombinuar me presionet e komunitetit që i izolojnë gazetarët serbë nga organet profesionale, dhe nga barrierat gjuhësore që qasjen e bëjnë më të vështirë. Vllahiu dhe Hoxha theksojnë atë që ata e quajnë papjekuri institucionale, ku autoritetet i fshehin faktet dhe më pas i sulmojnë mediat për spekulime, ndërsa

aktorë të tjerë si Lista Serbe mbajnë ndërprerje të komunikimit ashtu që mediat e Kosovës t'i detyrojnë të mbështeten në median serbe dhe në intervistat e rrugës. Ata argumentojnë për informime të shpeshta dhe të detajuara institucionale, dhe posaçërisht nga policia, ashtu që boshllëqet në informim të mos mbushen nga dezinformimi dhe taktikat e luftës hibride.

Disa redaktorë vërejnë se ndërhyrjet formale janë bërë më të rralla, por rreziku që inkuadrimi i pakujdesshëm të përdoret si armë është rritur. Tahiri raporton se nuk ka presion të drejtpërdrejtë, politik apo komercial, nga donatorët, por mundësinë e inkuadrimit të gabuar e trajton si rrezikun kryesor. Sadiku presionet i përshkruan si reale, por ato janë kryesisht të ambientit dhe politike, duke shpjeguar se ftesa mysafirëve të shquar serbë ka shkaktuar reagime negative dhe rreziqe fizike, dhe se përpjekjet për debate të hapura janë portretizuar si provokim. Përgjigja e tij është të veprojë profesionalisht, ta mbajë studion të hapur për zërat serb dhe të sigurojë mbulim sistematik të komuniteteve serbe në jug të Ibrit. Berisha vëren se projektet e financuara nga donatorët për t'i ulur tensionet janë zbehur, ndërkohë që platformat sociale të parregulluara janë shndërruar në arenat qendrore ku mbulimi i ekuilibruar damkoset si pro-serb, në një kontekst ku sulmet qeveritare ndaj medias kanë dëmtuar, si renditjen ndërkombëtare, ashtu edhe besimin e publikut.

Për Kerqukin, sfida më e vështirë është autocensura në kushte tabu. Aktorët politikë vendosin vija të qarta të kuqe dhe ai vëren se intervistimi i një deputeti të Listës Serbe është pothuajse i pamundur, ndërkohë që kuadrot e partisë gazetarët i mbikëqyrin me një xham zmadhues, duke bërë insinuata për lidhje me Serbinë dhe krijojnë stres të vazhdueshëm. Si në Kosovë, ashtu edhe në Serbi, skemat e granteve publike lënë mënjanë mediat kritike, ndërsa kërcënimet nga strukturat e pushtetit në veri, së bashku me ngacmimet e koordinuara të të ashtuquajturve të financuarve të pavarur nga jashtë, përbëjnë një presion të tërthortë, por të fuqishëm. Milutinovićja shton se objektiviteti është më i brishtë kur qasja në informacion shembet, për shembull gjatë vizitave të paparalajmëruara të nivelit të lartë, kur edhe ambasadat refuzojnë të japin detaje bazë ose përkthim, duke i lënë redaksitë në gjuhën serbe në një lloj modi të paparacëve. Vorgučići kujton marsin e vitit 2004 si provën më të vështirë të përmbajtjes profesionale dhe e sheh kufizimin kryesor aktual në raportimin që humanizon tjetrin.

Nga ana tjetër, Lazarevićja është e qartë se presioni politik dhe shoqëror ekziston dhe ndonjëherë është akut, dhe ajo argumenton se mohimi i tij është në vetvete një shenjë e vetëcensurimit. Sipas saj, retorika nacionaliste ka kontaminuar jetën publike, udhëheqësit sillen sikur të zotërojnë median, institucionet komunikojnë në një mënyrë njëkahëshe dhe boshllëqet e informacionit ftojnë manipulimin. Në këtë mjedis, redaktorët pritet të mbrojnë stafin e tyre duke ruajtur objektivitetin, edhe pse mediat sociale shpesh ndëshkojnë nuancat.

- **Stereotipet e Raportimit Mediatik: Mungesë më shumë se Fyerje, Disiplinë më shumë se Rrëshqitje**

Në të gjitha intervistat, stereotipet në mediat e Kosovës shfaqen më pak si fyerje e hapur dhe më shumë si padukshmëri, kornizime të thjeshta dhe dhoma jehonash politike. Shumica e mediave kryesore kanë përvetësuar disiplinën themelore gjuhësore dhe rrallë përdorin fyerje të hapura, por jeta e përditshme serbe dhe shqiptare mbetet kryesisht jashtë ekranit, kështu që kriza dhe politika e lartë vazhdojnë ta zëvendësojnë realitetin shoqëror.

Disa redaktorë mungesën në vend të fyerjes e identifikojnë si shtrembërimin kryesor. Mirena vëren se redaksitë kryesore të lajmeve kryesisht vetë-rregullohen, shmangin gjuhën përçmuese dhe u japin gjithnjë e më shumë hapësirë grupeve të cenueshme, por, megjithatë, jeta e përditshme e komuniteteve serbe mbulohet rrallë. Ai këtë ia atribuon një përzierjeje të vetë-izolimit brenda komuniteteve serbe, ndikimit të Beogradit dhe burimeve të kufizuara të dedikuara për raportim nga komuniteti. Syla ilustron se si kornizat nacionaliste stigmatizojnë mospajtimin, duke sjellë ndër mend atë se kur media e tij kundërshtoi tarifën prej 100% mbi mallrat serbe, ajo u etiketua si pro-serbe, edhe pse kjo masë më vonë u anulua, gjë që ai e sheh si dëshmi se narrativat ndëshkuese mund të disiplinojnë mediat që largohen nga skenari mbizotërues.

Në këtë kontekst, disa të intervistuar argumentojnë për një perspektivë ku shtetësia është e para. Matoshi këmbëngul që komunitetet joshumicë nuk duhet të trajtohen si në thelb anti-shtetërore dhe se etnia duhet të theksohet vetëm kur është relevante nga ana shkakësore, ku njerëzit paraqiten së pari si qytetarë. Rexha propozon të fillohet nga çështjet njerëzore, të përditshme, siç janë uji, rrugët dhe shërbimet që kalojnë përtej vijave të komunitetit. Ai vëren se mediat qendrore ende rrallë dërgojnë ekipe në Graçanicë për lajme të zakonshme, ndërsa Radion Evropa e Lirë dhe shërbimin në gjuhën serbe të RTK-së i tregon si shembuj pozitivë që bashkëjetesën e shprehin pa shenja stereotipi. Vllahiu në mënyrë të ngjashme pohon se stereotipi mbizotërues është padukshmëria, pasi mediat në të dyja anët kanë tendencë që njëra-tjetrën ta shohin më parë gjatë krizave sesa në jetën e përditshme në Graçanicë, Mitrovicë të Veriut, Kllokot ose Partesh. Rregulli i tij udhëheqës është po ashtu që shtetësia të emërtohet e para, meqë etiketimet e rastësishme etnike një krim të zakonshëm mund ta shndërrojnë në diçka që duket të jetë një incident etnik.

Të tjerët përqendrohen në mikromekanikën e përfaqësimit. Hoxha shumicën e artikujve i gjen përgjithësisht të drejtë, por titujt dhe kornizat formulaike i identifikon si pika të dobëta, dhe posaçërisht në kohën kur gjyqet për krime lufte në mungesë rriten. Meqë gazetarët e rinj nuk kanë njohuri të drejtpërdrejta për veriun dhe mediat sociale e inkubojnë nacionalizmin e papërpunuar kolektivist, ai shkrimin e titujve e sheh si një vend kritik për disiplinën editoriale. Tahiri kundërshton stereotipet duke nxjerrë në pah fakte përçarëse, për shembull një rast kur një familje lokale serbe ishte e para që e njojftoi policinë pas një shpërthimi, një detaj ky që shumë media e kanë lënë jashtë, sepse i sfidonte palët e supozuara. Ai po ashtu kritikon tituj të tillë si

“Një serb i arrestuar në Jarinje,” ku kombësia është e parëndësishme, si dhe fajësimin refleksiv të shqiptarëve për vandalizmin nëpër kisha pa kurfarë provash.

Pluralizmi dhe dizajni i formatit janë një shtresë tjetër e praktikës antistereotipike. Sadiku mbështet procedurat që ndërtojnë programe rreth pikëpamjeve kontradiktore, të ankoruara në standarde të bazuara në të drejta dhe një përzierje të dukshme gjithëpërfshirëse të të ftuarve. Objektivi është mospajtimi i sinqertë sipas rregullave të përbashkëta dhe jo harmonia kozmetike. Ai paralajmëron kundër analogjive të rreme historike, për shembull barazimi i situatës së sotme të serbëve me atë të shqiptarëve në vitet 1990, të cilat fryjnë pakënaqësinë. Për Berishën, praktika e mirë fillon me vendimet se kush ftohet dhe si paraqitet, dhe ai argumenton se më shumë zëra serbë, duke përfshirë politikanë, akademikë dhe aktivistë si Nataša Kandić, duhet të jenë të pranishëm për të kundërshtuar narrativat nacionaliste. Megjithatë, frika nga sulmet në mediat sociale dhe hakmarrjet politike i bën redaktorët të kujdesshëm në lidhje me ftesën e bashkëbiseduesve jopopullorë, gjë që përforcon një model të dukshmërisë “ne kundrejt atyre.”

Gjuha, struktura dhe etosi profesional e formojnë një grup të katërt përgjigjesh. Kerquki argumenton se strategjitë kundër stereotipeve fillojnë me zgjedhje të kujdesshme të fjalëve dhe harqe narrative që dekurajojnë mbajtjen e pikëve në mënyrë fisnore dhe orientojnë audiencën drejt të kuptuarit. Dimitrijević thekson terminologjinë e disiplinuar përtej vijave kombëtare, fetare dhe gjinore, dhe vendos një kufi të qartë kundër gazetarëve që shfaqin shenja partiake ose nacionaliste, për shembull, mbulesa telefoni me shenjën e UÇK-së, të cilat dëmtojnë neutralitetin. Trajnimi, veçanërisht për gazetarët e rinj, shihet si thelbësor. Milutinovićja i thekson historitë njerëzore dhe shqetësimet e përbashkëta qytetare, duke vënë në dukje se programet e hershme të Kontakt Plusit nxorën në pah të drejtat e shqiptarëve, romëve dhe të boshnjakëve në veri të qytetit të Mitrovicës, të ndjekura më vonë nga artikuj mbi trashëgiminë kulturore jomateriale.

Së fundmi, disa botime mediale normat antistereotipike i ngulisin drejtpërdrejt në stilin e tyre të shtypit. Në KIM, Vorgučić i kushton rëndësi disiplinës leksikore, duke përdorur emra institucionalë ashtu siç njihen zyrtarisht në Kosovë, duke shmangur kualifikuesit delegjitimues si “e ashtuquajtura” dhe duke shkruar në vend të kësaj “Kosovë” në një formë neutrale, pos në titujt zyrtarë të cituar. Ai argumenton se kjo qëndrueshmëri zvogëlon aktivizimin e stereotipeve dhe sinjalizon respekt për audienca të ndryshme. Lazarević e përshkruan qasjen e KoSSev-it si një kombinim të pluralizmit rigoroz dhe kontekstualizimit të thellë, duke bashkuar perspektiva, afate kohore dhe argumente të verifikuara nga të dyja komunitetet, madje edhe në tema në dukje të thjeshta si ura e Mitrovicës. Sipas saj, heqja e tabuve nga çështjet që janë shmangur prej kohësh është mënyra më efektive për t’i thyer paragjykimet.

- **Si Mund t'i Kontribuojnë Mediat Pajtimit**

Në të gjitha intervistat, gazetarët pajtohen se mediat mund ta mbështesin pajtimin në Kosovë, por vetëm kur kushtet dhe burimet politike e lejojnë këtë. Ata botimet mediale i shohin si ndërtuese urash që e zgjerojnë hapësirën për bashkëjetesë kur i rezistojnë polarizimit dhe përqendrohen në shqetësimet e përditshme.

Shumë të intervistuar i theksojnë formatet që zërat shqiptarë dhe serbë i vënë në bisedë të drejtpërdrejtë. Rexhepi, si një mënyrë për ta normalizuar punën bashkëpunuese, i thekson projektet ndër-redaktoriale të lajmeve dhe raportimin e përbashkët nga perspektiva të shumëfishta. Syla bën thirrje për debate në kohën kryesore që bashkojnë gazetarët serbë dhe shqiptarë të cilët janë të përgatitur që t'i sfidojnë kampet e tyre politike. Berisha e mbështet po ashtu debatin e qëndrueshëm ballë për ballë në studio të përbashkëta, dhe programet që zbardhin dezinformimin dhe gjuhën abuzive në mediat sociale. Për Rexhën, çelësi është që të gjitha komunitetet të shfaqen rregullisht në hapësirat kryesore mediatike të njëra-tjetrës dhe ai argumenton se nevojitet një kapacitet më i fortë dygjuhësh në redaksi ashtu që shkëmbimet e tilla të bëhen rutinë.

Të intervistuar të tjerë theksin e vënë te raportimi lokal. Hoxha argumenton se pajtimi varet nga trajtimi i një kanalizimi të bllokuar në Leposaviq në të njëjtën mënyrë si ai në Junik dhe nga dërgimi i ekipeve në komunat e nën-raportuara, si serbe, ashtu edhe shqiptare, edhe kur nuk ka krizë. Dimitrijevići dhe Milutinovićja i japin përparësi rrëfimeve dhe mbulimit të përditshëm që tregojnë se si ndryshimet e politikave ndikojnë në jetët e njerëzve. Duke u përqendruar në shërbime, infrastrukturë dhe rutina familjare, gazetarët mund të zbulojnë probleme të përbashkëta dhe ta ngushtojnë kornizimin politik të shumës zero. Vorgučić nënvizon se serbët janë një komunitet i vogël dhe se diskursi publik shpesh e trajton integrimin si një negocim të largët midis Beogradit dhe Prishtinës dhe jo si një marrëdhënie lokale midis fqinjëve. Sipas tij, media mund ta kundërshtojë këtë duke normalizuar lidhjet praktike dhe duke i rezistuar përgjithësimeve që i portretizojnë të gjithë serbët si të pavullnetshëm për t'u integruar.

Një fushë e tretë ka të bëjë me normat profesionale. Mirena argumenton se media nuk mund t'i transformojë marrëdhëniet vetë pa politika deeskaluese dhe pa mbështetje nga shoqëria civile, por ato mund ta zvogëlojnë dëmin duke përdorur ndalesa të gjuhës së urrejtjes, duke shmangur stereotipet etnike dhe duke vepruar si partnerë kryesorë në projektet e pajtimit në vend që të mbeten ofrues periferikë të raportimit. Matoshi detyrën qendrore e sheh si përballje sistematike të stereotipeve dhe nacionalizmit të shumicës, dhe posaçërisht të reflekseve anti-serbe, në mënyrë që barazia para ligjit dhe përkatësia qytetare të bëhen tipare normale të mbulimit të përditshëm. Kerquki pajtimin e lidh me ruajtjen e pluralizmit, i cili sipas tij kërkon terminologji të kujdesshme, qasje në të gjithë zërat relevantë, rezistencë ndaj vetë-censurës dhe njohuri më të thellë mediatike të audiencës në mënyrë që raportimi ndëretnik të mos interpretohet përmes një lente të shumës zero. Lazarevićja paralajmëron kundër një industrie paqeruajtëse të drejtuar nga donatorët dhe raportimit pozitiv thjesht performues, dhe në vend të kësaj argumenton për gazetari profesionale të pa-kompromis që trajton edhe tema të vështira siç janë krimet e luftës.

Së fundmi, të intervistuarit nxjerrin në pah kushtet mundësuese. Tahiri propozon një "dialog të brendshëm" të udhëhequr nga media përmes programeve të rregullta dygjuhëshe mbi përvojat e pajtimit diku tjetër, të ankoruara në një hapësirë të përbashkët mediatike shqip-serbisht-anglisht në Mitrovicë, por këmbëngul se, për të qenë të qëndrueshme, formatet e tilla duhet të jenë në pronësi të redaksisë. Sadiku i cakton gazetarisë një mandat të dyfishtë, për të raportuar fakte, dhe për të orientuar opinionin publik kur politika shkon keq, duke bërë thirrje për një "marrëveshje të heshtur" midis mediave për të trajtuar temat ndëretnike me përmbajtje dhe për të zgjeruar takimet midis mysafirëve shqiptarë dhe serbë, duke përfshirë mbulimin e komuniteteve serbe në Jug. Milutinović tregon projektet e lexim-shkrimit mediatik dhe demaskimin e "lajmeve të rreme" si mënyra për të zvogëluar ndjeshmërinë ndaj propagandës. Vllahiu thekson se retorika "nga lartë" përcakton sjelljen "poshtë" dhe përkrah debate të përbashkëta rutinore, kontaktin me redaksinë dhe shkëmbimin e materialeve në mënyrë që dialogu të jetë normal dhe jo i nxitur nga kriza. Mirena vëren se toni i vendosur nga udhëheqësit politikë dhe disponueshmëria e burimeve në fund të fundit formësojnë se sa larg mund të shkojnë përpjekjet mediatike.

- **Bashkëpunimi me Mediat e Etnive të Tjera**

Në të gjitha intervistat, bashkëpunimi midis mediave në gjuhën shqipe dhe serbe duket i vërtetë, por i brishtë, i bazuar në lidhje personale, shkëmbime ad hoc dhe projekte të nxitura nga donatorët, në vend në një sistem të qëndrueshëm dhe të institucionalizuar të prodhimit të përbashkët.

Disa gazetarë e përshkruajnë një shtresë praktike dhe të përditshme të bashkëpunimit. Rexhepi përmend një memorandum formal mirëkuptimi me KoSSevin për ndarjen e përbashkët të përmbajtjes, të plotësuar nga shkëmbime të rregullta joformale me KontaktPlusin dhe Radio Goraždevacin. Syla e portretizon bashkëpunimin si kryesisht pragmatik, duke përfshirë verifikimin e fakteve me kolegët në Beograd, ndarjen e kontakteve për intervista dhe ofrimin e hapësirës së punës kur ekipet raportojnë nga Kosova. Për Matoshin, bashkëpunimi është gjithashtu personal dhe i drejtpërdrejtë, për shembull përmes deklaratave të shpeshta për mediat serbe si Danas, të cilat ai i sheh si një mënyrë për t'i sfiduar narrativat e izoluara.

Rexha vëren se forma më e qëndrueshme e bashkëpunimit është solidariteti profesional midis gazetarëve individualë. Gazetarët ndajnë kontaktet, lehtësojnë intervistat, ndihmojnë me përkthime dhe mbështeten në media të besueshme të anës tjetër, me mediat e Kosovës që i drejtohen KoSSev për zhvillimet në veri dhe gazetarët serbë që përdorin KOHËn dhe mediat e tjera me bazë në Prishtinë për informacion në lidhje me institucionet qendrore. Një bashkëpunim më i strukturuar midis redaksive në përgjithësi varet nga mbështetja e donatorëve nga aktorë të tillë si BE-ja, Këshilli i Evropës ose UNMIK-u, ndërsa AGK-ja dhe OSBE-ja ofrojnë trajnime dhe kurse të përbashkëta gjuhësore për gazetarët shqiptarë dhe serbë.

Të tjerë theksojnë se bashkëpunimi është sporadik dhe jo i institucionalizuar në mënyrë të vendosur. Vllahiu përjeton kontakt kryesisht përmes ngjarjeve të AGK-së, konferencave

ndërkombëtare dhe shkëmbimeve të rastit, dhe argumenton se ajo që mungon është një urë e përhershme për ndarjen rutinore të përmbajtjes dhe punën e përbashkët. Hoxha thekson një kulturë profesionale funksionale, duke filluar nga bashkë-prezantimi i një podkasti serbisht dhe shqip me Vorgučićin e deri te ekipet në terren që i ndajnë pajisjet bashkarisht, ku anglishtja rëndom shërben si një lingua franca praktike. Ai dhe shumë të tjerë theksojnë po ashtu se dygjuhësia e kufizuar është një pengesë strukturale për bashkëprodhime më të thella dhe se projektet e përbashkëta zakonisht kërkojnë planifikim të qëllimshëm dhe mbështetje nga donatorët.

Aty ku janë të pranishme aftësitë gjuhësore, ato ndryshojnë dinamikën në thellësi. Tahiri e përshkruan bashkëpunimin me kolegët serbë si të shkëlqyer dhe vëren se bashkëveprimi i drejtpërdrejtë ndihmon në zbutjen e paragjykimeve nga të dyja palët. Ai bën thirrje për një bashkëpunim shumë më sistematik me mediat lokale në gjuhën serbe si shtylla kurrizore e një hapësire informative mirëfilli ndëretnike. Sadiku, përkundrejt kësaj, thekson se projektet e institucionalizuara midis redaksive janë të rralla. Sipas përvojës së tij, përpjekjet për të nisur prodhime të përbashkëta ose debate paralele shpesh kanë dështuar për shkak të narrativave të viktimizimit politik, hezitimit profesional dhe mbështetjes së kufizuar ndërkombëtare. Pa mbështetje më të fortë nga OJQ-të dhe partnerët ndërkombëtarë, bashkëpunimi mbetet kryesisht ad hoc.

Berisha vëren se kufizimet politike dhe strukturore kanë një peshë të madhe. Ai nuk sheh pothuajse asnjë bashkëpunim të strukturuar përtej shërbimeve në gjuhët e komuniteteve joshumicë të RTK-së dhe shpjegon se nismat private janë zbehur në një klimë ku bashkëpunimi me mediat serbe mund të shkaktojë sulme të koordinuara nga grupet online dhe ata në pozita pushteti. Megjithatë, ai mbështet bashkëpunimin pragmatik në tema jopolitike si shëndetësia, arsimi, kultura dhe siguria publike si një mënyrë me një kosto relativisht të ulët për ta rindërtuar besimin. Kerquki po ashtu thekson mungesën e partneriteteve të qëndrueshme institucionale dhe mbështetjen në një grup të vogël mediash të besueshme, shpesh të financuara ndërkombëtarisht, dhe argumenton për krijimin e një platforme të përhershme për bashkëpunim ndër-redaktorial.

Dimitrijević, Milutinović, Vorgučić dhe Lazarević theksojnë të gjithë se bashkëpunimi është episodik dhe i kufizuar nga burimet. Dimitrijević përmend koalicionin Zëri i Komunitetit në rajonin e Pejës dhe të Prizrenit, ku stacionet lokale prodhojnë së bashku lajme mbi çështje të përditshme, siç janë kufizimet e ujit dhe infrastruktura, të cilat ai i sheh si dëshmi se bashkëpunimi rutinor me kosto të ulët për problemet e jetës së përditshme mund të ndërtojë familjaritet dhe besim. Milutinović bën dallimin midis kontakteve më të lehta të sotme, duke përfshirë vizitat studimore, shkëmbimet dhe mbështetjen në portale si KOHA për materiale të përkthyera, me rrjetet e mëparshme që ishin më të përqendruara në përmbajtje të përbashkët, dhe vëren se zvogëlimi i madhësisë e ka bërë më të vështirë prodhimin e qëndrueshëm të përbashkët.

Vorgučić e përshkruan solidaritetin në terren dhe shkëmbimet e herëpashershme të materialeve si të realizueshme, por sporadike, të ngjashme me modelin e bashkëpunimit brenda vetë medias

në gjuhën serbe. Lazarević thekson stafin shumë të vogël, presionin e lajmeve të fundit dhe kapacitetin e kufizuar për të vendosur reporterë brenda komuniteteve të tjera si pengesa të mëdha. Ajo gjithashtu nënvizon se bashkëpunimi shpesh merr formën e mbështetjes së ndërsjellë në raportimin dhe përkthimin e njëri-tjetrit, të cilat ndonjëherë mund të shtrembërohen nga kërkesa të parapërgatitura nga mediat më të mëdha që kërkojnë kryesisht citate konfirmuese.

- **Politikat Mediatike për Kundërshtimin e Narrativave që Dëmtojnë Marrëdhëniet Ndëretnike**

Në të gjitha intervistat, politikat mediatike për t'i kundërshtuar narrativat që i dëmtojnë marrëdhëniet ndëretnike përshkruhen si pjesë e një ekosistemi më të gjerë që përfshin standardet profesionale në redaksi, sjelljen e përgjegjshme të shtetit, rregullatorët e fuqizuar, mbështetjen afatgjate të donatorëve dhe njohuritë mediatike në të gjithë shoqërinë. Gazetarët theksojnë se pa deeskalimin politik dhe mbështetjen strukturore, kodet editoriale më vete nuk mund t'i neutralizojnë narrativat polarizuese, edhe pse ata ato kode i konsiderojnë ende si vijën e parë të mbrojtjes.

Në thelb është praktika rigoroze profesionale. Rexhepi thekson respektimin e rreptë të Kodit të Shtypit dhe raportimin e bazuar në të vërtetën, duke vënë në dukje mungesën relative të rasteve të fundit të gjuhës së urrejtjes mbi baza etnike në Këshillin e Medias së Shkruar. Marrëveshjet për ndarjen e përmbajtjes, të tilla si ato me KosSev, shihen si mjete politike në vetvete, duke qarkulluar informacion të verifikuar nëpër audienca të ndara dhe duke zvogëluar hapësirën për shtrembërim.

Propozime të tjera përqendrohen në përgjegjësitë e shtetit dhe institucioneve të tij. Rexha bën thirrje për financim publik të shënjestruar siç duhet për mediat jo-shumicë, qasje në informacion në gjuhët jo-shumicë dhe mbështetje të qëndrueshme për botimet mediale të vogla si Romano Avazo, të cilat ai i sheh si shtyllën kurrizore të një hapësire informative mirëfilli shumëetnike. Vllahiu mbështet një qasje të tërë shoqërisë në të cilën shoqëria civile krijon kontakte ndër-komunitare, politika bëhet burim besimi në vend të përçarjes dhe media përdor si gjuhë të parë atë të qytetarisë, me qasje të garantuar në informacionin zyrtar në kohë krize. Hoxha argumenton në mënyrë të ngjashme se partitë instrumentalizojnë Serbinë për t'i fshehur dështimet e qeverisjes dhe për ta përshkallëzuar shpifjen përmes shoqërimit, dhe ai bën thirrje për komunikim institucional të qartë dhe me kohë dhe për zbatim të qëndrueshëm të kodeve ekzistuese të transmetimit dhe shtypit.

Disa të intervistuar theksojnë se udhëheqësit politikë përcaktojnë kufirin e sipërm të diskursit publik. Tahiri argumenton se nëse Kryeministri dhe Presidenti heqin retorikën përjashtuese nga gjuha e tyre dhe angazhojnë dukshëm komunitetet jo-shumicë në mjediset e tyre lokale, kjo do të ndikonte në institucione dhe në shoqërinë në tërësi. Ai i nxit gazetarët të shmangin etiketat etnike, përveç nëse ato janë thelbësore, dhe t'i rezistojnë kornizave formuluese që krimin e zakonshëm e shndërrojnë në incident etnik. Qasja e Sadikut fillon me institucione

gjithëpërfshirëse, bazuar në një dialog të brendshëm me serbët e Kosovës dhe komunikim rutinë dhe të hapur, ndërsa media dhe shoqëria civile ruajnë raportimin profesional, plural dhe me fakte të verifikuara, dhe i rezistojnë etnizimit të historive për klikime. Berisha shton se udhëheqësit duhet ta frenojnë retorikën triumfaliste, dhe posaçërisht lidhur me veprimet policore në veri, dhe të sigurojnë informime të shpeshta institucionale për t'i kufizuar thashethemet. Ai po ashtu argumenton se redaksia duhet t'i zbatojë rregullat etike, të mbrojë stafin në detyra me rrezik të lartë dhe të investojë shumë në trajnimin e gazetarëve të rinj.

Përtej praktikës dhe politikës së drejtpërdrejtë, të intervistuarit i drejtohen gjithashtu rregullatorëve, njohurive mediatike dhe nxitjeve strukturale. Kerquki dhe Milutinovićja bëjnë thirrje për mbikëqyrje më të fortë rregullatore, monitorim të pavarur të narrativave të dëmshme, udhëzime të qarta për ndjeshmërinë etnike dhe programe trajnimi të qëndrueshme, me shtytës që shpërblejnë gazetarinë ndëretnike përtej projekteve afatshkurtëra. Të dy vërejnë një boshllëk në zbatim, dhe posaçërisht lidhur me retorikën nxitëse, dhe cenueshmërinë e krijuar kur pothuajse kushdo mund të veprojë si gazetar në mediat sociale. Dimitrijevići argumenton se lidershipi dhe një ripërtëritje e gjuhës publike nga të dyja palët janë parakushte për normalizim; derisa kjo të ndodhë, ai beson se media duhet të përforcojë etikën e zbatueshme, korrigjimet transparente dhe solidaritetin profesional ndëretnik, ashtu siç u demonstrua gjatë përleshjeve në Zveçan.

Vorgučić dhe Lazarević e zgjerojnë diskutimin në ndryshimet shoqërore afatgjata. Vorgučić mbështet përballjen me trashëgimitë e kohës së luftës përmes proceseve të ngjashme me iniciativat e të së vërtetës dhe pajtimit dhe përmes masave të përkohshme afirmative për komunitetet joshumicë në një shoqëri ku mbizotëron shumica, të kombinuara me një hartim të kujdesshëm që shmang kriminalizimin e komuniteteve të tëra dhe me lexim-shkrueshmërinë mediatike në shkolla për të ndihmuar në çmësimin e stereotipeve. Lazarević bën thirrje për një politikë llogaridhënieje dhe një politikë etike që do të zbatohej, si për institucionet, ashtu edhe për donatorët dhe për median, dhe që donatorët të largohen nga projektet sipërfaqësore shumëetnike drejt mbështetjes së qëndrueshme për gazetarinë profesionale me shtrirje të vërtetë dhe thellësi kontekstuale. Sipas saj, dhe në të gjitha këto perspektiva, emëruesi i përbashkët është se kundërshtimi i narrativave dëmtuese ndëretnike nuk varet nga përmbajtja simbolike e paqes, por nga strukturat e qëndrueshme që shpërblejnë gazetarinë e bazuar në fakte, të përqendruar në të drejta, dhe të deetnizuar.

- **Kornizimi Editorial Sipas Mediave**

Ndarja sipas mediave tregon se çështjet ndëretnike trajtohen kryesisht përmes një këndvështrimi të sigurisë, me relativisht pak hapësirë për narrativa të qarta pajtuese. Në shumicën e mediave në gjuhën shqipe dhe serbe, artikujt e linjës së ashpër ose të fokusuar në siguri në një masë shumë të madhe ia kalojnë në numër atyre që janë të orientuar drejt dialogut, ndërsa raportimi neutral ose administrativ e luan një rol dytësor, stabilizues.

Në mesin e transmetuesve dhe portaleve në gjuhën shqipe, disa mbizotërohen qartë nga raportimi i fokusuar te siguria. Në RTV21, ATV, Kanal 10, Indeks Online, Nacionale dhe posaçërisht në Kosova Press, ku të gjitha çështjet përkatëse bien në kategorinë e sigurisë ose të vijës së ashpër, raportimi mbi çështjet ndëretnike përqendrohet kryesisht në incidente, kërcënime ose ngjarje policore, ndërsa përmbajtja shprehimisht pajtuese rrallë tejkalon dhjetë përqind dhe në disa media mungon në tërësi.

Gazeta Express, Klan Kosova, KTV dhe Kallxo.com shfaqin profile më të përziera. Ato ende kanë një sasi të konsiderueshme raportimesh të linjës së ashpër, në afërsisht gjysmën e artikujve, por ato po ashtu kanë edhe segmente më të mëdha neutrale dhe, në rastin e KTV dhe Kallxo, pjesët më të larta të përmbajtjes që vë në plan të parë dialogun, në rreth një e pestën e artikujve. Kjo tregon se, megjithëse kornizat e sigurisë mbeten mbizotëruese, disa media kryesore kombinojnë sistematikisht raportimin institucional me narrativa që të paktën herë pas here janë të orientuara drejt pajtimit.

Është edhe një grupim tjetër që karakterizohet nga një prodhim i lartë neutral/burokratik. Një numër shumë i madh, ose madje edhe shumica e artikujve që i botojnë Telegrafi dhe Metro janë neutralë. Ky model e tregon një preferencë për raportim institucional, shumë-burimor, ose të përqendruar në procese, që situatën, as nuk e përshkallëzon në mënyrë të qartë, dhe as nuk e qetëson në mënyrë aktive, por inkuadrimin emocional e mban nën kontroll.

Brenda ekosistemit në gjuhën serbe, Kosovo Online dallohet për kombinimin e një profili të fortë që vë në plan të parë sigurinë, me shkallën më të lartë të përmbajtjes stigmatizuese/tjetërsuese (mbi 17%), dhe pa asnjë artikull pajtues. Për dallim nga kjo, KosSev dhe RTV KIM anojnë shumë drejt repertorëve neutralë ose të përzier neutralë-të linjës së ashpër, me stigmatizim të papërfillshëm dhe segmente të vogla, por të pranishme, që vënë në plan të parë dialogun. Radio Goraždevaci ndodhet midis këtyre poleve, me një shumicë artikujsh të linjës së ashpër, por me një tjetërsim që është vetëm margjinal.

Në përgjithësi, të dhënat tregojnë për një rrymë kryesore relativisht të disiplinuar që në një masë të madhe i shmang fyerjet e hapura etnike, po është strukturalisht e orientuar drejt raportimit të sigurisë. Raportimi pajtues mbetet një zhanër minoritar në të gjitha mediat, ndërsa narrativat stigmatizuese janë të përqendruara në disa aktorë. Efekti neto është një hapësirë informacioni që tenton më shumë që ta menaxhojë dhe burokratizojë tensionin sesa të promovojë në mënyrë aktive pajtimin.

Shtëpia Mediale	Artikuj Totali	Pajtues / Dialogu-së-pari	Linja e fortë / Siguria-së-pari	Stigmatizuese / Tjetërsuese	Neutrale / Burokratike
RTV 21	31	3 (9.6%)	22 (70.1%)	0 (0.0%)	6 (19.3%)
ATV	21	1 (4.7%)	15 (71.4%)	1 (4.7%)	4 (19.2%)
Gazeta Express	36	4 (11.1%)	18 (50.0%)	0 (0.0%)	14 (38.9%)
Indeks Online	29	3 (10.3%)	15 (51.7%)	0 (0.0%)	11 (37.9%)
KTV	77	16 (20.8%)	36 (46.7%)	0 (0.0%)	25 (32.5%)
Kallxo.com	66	15 (22.7%)	13 (19.7%)	0 (0.0%)	38 (57.6%)
Kanal 10 (Gazeta 10)	39	1 (2.6%)	25 (64.1%)	0 (0.0%)	13 (33.3%)
Klan Kosova	39	4 (10.2%)	25 (64.1%)	0 (0.0%)	10 (25.7%)
Kosova Press	15	0 (0.0%)	15 (100.0%)	0 (0.0%)	0 (0.0%)
Kosovo Online	81	0 (0.0%)	37 (45.7%)	14 (17.3%)	30 (37.0%)
KosSev	149	3 (3.4%)	42 (28.6%)	0 (0.0%)	100 (68.0%)
Metro	56	8 (14.3%)	14 (25.0%)	0 (0.0%)	34 (60.7%)
Nacionale	15	1 (6.7%)	8 (53.3%)	0 (0.0%)	6 (40.0%)
RTV KIM	82	11 (13.4%)	30 (36.6%)	0 (0.0%)	41 (50.0%)
Radio Goraždevac	79	4 (5.3%)	42 (55.3%)	1 (1.3%)	29 (38.1%)
Telegrafi	18	0 (0.0%)	5 (27.8%)	0 (0.0%)	13 (72.2%)

Përfundim

Nga aspekti etik, mjedisi mediatik i Kosovës për marrëdhëniet ndëretnike është më i disiplinuar sesa në të kaluarën, por mbetet strukturalisht i anuar drejt sigurisë, krizës dhe politikës së lartë, në vend se drejt bashkëjetesës së përditshme. Mediat kryesore në gjuhën shqipe dhe serbe kryesisht e shmangin gjuhën eksplicite të urrejtjes, mbështeten në Kodin Kombëtar të Etikës dhe përdorin standarde më të larta verifikimi, gjuhë të deetnizuar dhe mbikëqyrje të nivelit të lartë për t'i qetësuar storjet potencialisht acaruese. Megjithatë, në të gjitha mediat, kornizat e vijës së ashpër ose të sigurisë në radhë të parë mbizotërojnë ende, narrativat e orientuara drejt pajtueshmërisë mbeten margjinale dhe përmbajtja më stigmatizuese është e përqendruar në një grup të vogël mediash shumë të politizuara në gjuhën serbe dhe shqipe.

Gazetarët veprojnë në një mjedis të presionit, më parë se të një censure të drejtpërdrejtë. Brishtësia ekonomike, tkurrja e mbështetjes së donatorëve, institucionet jotransparente dhe shpesh të papjekura, rrjetet militante online dhe propaganda ndërkufitare, posaçërisht nga mediat e lidhura me Beogradin, të ndjekura nga serbët e Kosovës, të gjitha këto e ngushtojnë hapësirën për raportim të pavarur dhe inkurajojnë kujdesin ose vetëcensurën, dhe posaçërisht në veri. Kufizimet strukturore e thellojnë këtë model, pasi deficitet gjuhësore, prania e kufizuar në terren në zonat me shumicë serbe, dhe dy ekosisteme mediatike kryesisht paralele, shqiptare dhe serbe, krijojnë një stereotip mungese, më parë se të fyerjes së hapur, pasi jeta e zakonshme ndërkomunitare rrallë herë raportohet fare.

Në të njëjtën kohë, vlerësimi tregon se disa media profesionale tashmë modelojnë një rol më konstruktiv. Ato investojnë në raportim bazuar në burime të shumëfishta dhe formate më të gjata që përfshijnë zëra të komuniteteve joshumicë, përdorin programe që sjellin mysafirë shqiptarë dhe serbë në të njëjtin studio, miratojnë gjuhë që qytetarinë e vë në plan të parë, dhe përmes ndarjes së përmbajtjes dhe projekteve të përbashkëta angazhohen në bashkëpunim praktik edhe përtej ndarjes gjuhësore. Redaktorët janë të qartë se media nuk munden që pajtimin ta ofrojnë vetë, pasi udhëheqësit politikë, rregullatorët, donatorët dhe institucionet vendosin kufijtë e jashtëm të asaj që është e mundur. Nëse këto struktura më të gjera shpërblejnë raportimin dygjuhësh, të orientuar kah të drejtat dhe jo kah kriza, në vend të polarizimit dhe përmbajtjes sensacionale, rrjedha kryesore profesionale e Kosovës mund të veprojë jo vetëm si një tampon kundër përshkallëzimit, por edhe si një forcë e ngadaltë dhe e qëndrueshme për normalizimin e jetës së përbashkët qytetare përtej vijave etnike.

4. Analiza e Sondazheve të Opinionit

Ky seksion ofron një analizë të thellë të omnibus sondazhit të UBO Consulting për marrëdhëniet ndëretnike dhe pajtimin në Kosovë (N ≈ 1,165), të porositur nga KIPRED-i, dhe të kryer në shtator 2025. Shqyrtimi është strukturuar rreth pesë dimensioneve kryesore: (1) rëndësia normative e marrëdhënieve ndëretnike dhe kërkesa publike për një axhendë politike, (2) besimi në media, (3) ndikimi i perceptuar i medias dhe narrativave politike, (4) a kuptohen narrativat politike si lehtësim apo pengim i pajtimit, dhe (5) implikimet kryesore strategjike.

- **Baza normative – rëndësia e marrëdhënieve ndëretnike dhe kërkesa për një axhendë pajtimi**

Sa të rëndësishme janë për ju marrëdhëniet ndëretnike dhe pajtimi midis grupeve etnike në Kosovë?

		Frekuenca	Përqindja	Përqindja Valide	Përqindja Kumulative
Valide	Shumë të rëndësishme	450	38.6%	38.6%	38.6%
	Të Rëndësishme	456	39.2%	39.2%	77.8%
	Paksa të Rëndësishme	210	18.0%	18.0%	95.8%
	Aspak të Rëndësishme	49	4.2%	4.2%	100.0%
	Totali	1165	100.0%	100.0%	

Përgjithësisht, 38.6 përqind e të anketuarve këto marrëdhënie i konsiderojnë shumë të rëndësishme dhe 39.2 përqind e tyre këto i konsiderojnë si të rëndësishme. Vetëm 18.0 përqind ato i shohin si pak të rëndësishme dhe 4.2 përqind si aspak të rëndësishme. Të marra së bashku, pothuaj 78 përqind marrëdhëniet ndëretnike dhe pajtimin i vlerësojnë si të rëndësishme ose shumë të rëndësishme, ndërsa rreth një në pesë veta, ato i vë poshtë në axhendën e vet personale.

Ky nivel i lartë i rëndësisë së deklaruar është përgjithësisht i qëndrueshëm në të gjitha grupet. Ndër të anketuarit shqiptarë, 38.7 përqind këto marrëdhënie i vlerësojnë si shumë të rëndësishme dhe 38.3 përqind si të rëndësishme, ndërsa 18.6 përqind ato i shohin si pak të rëndësishme dhe 4.5 përqind si të parëndësishme. Ndër të anketuarit serbë, 37.3 përqind ato i konsiderojnë si shumë të rëndësishme dhe 34.3 përqind si të rëndësishme, me 25.4 përqind që thonë se janë pak të rëndësishme dhe vetëm 3.0 përqind që thonë aspak të rëndësishme. Të anketuarit nga komunitetet e tjera janë më të përkushtuarit normativë, me 39.1 përqind që i përshkruajnë marrëdhëniet ndëretnike si shumë të rëndësishme dhe 56.5 përqind si të rëndësishme, dhe me pak më shumë se 4 përqind që ato i vendosin në dy kategoritë më të ulëta.

Sipas moshës, nuk ka ndonjë ndarje të madhe brezash. Në të gjitha grupmoshat, afërsisht tre të katërtat ose më shumë marrëdhëniet ndëretnike i konsiderojnë si të rëndësishme, vetëm me ndryshime fare të vogla. Burrat kanë pak më shumë gjasa se gratë që ato t'i përshkruajnë si shumë të rëndësishme (42.4 përqind krahasuar me 34.8 përqind), por kur të kombinohen shumë e rëndësishme dhe e rëndësishme, të dyja gjinitë bien qartë në kampin pro-rëndësisë.

Kështu, pothuaj dy të tretat mbështesin qartë një axhendë pajtimi, dhe rezistenca e hapur është shumë e kufizuar. Ajo që bie në sy është më pak niveli i kundërshtimit se grupi i konsiderueshëm "i pasigurtë" prej rreth një të tretës, pikëpamjet e të cilëve ende mund të formësohen në të dyja drejtimet.

A mendoni se politikanët e Kosovës duhet të kenë një qasje më të qartë dhe më të hapur për promovimin e pajtimit ndëretnik?

		Frekuenca	Përqindja	Përqindja Valide	Përqindja Kumulative
Valide	Po	733	62.9%	62.9%	62.9%
	Nuk jam i sigurt	374	32.1%	32.1%	95.0%
	Jo	58	5.0%	5.0%	100.0%
	Total	1165	100.0%	100.0%	

Në përgjithësi, 62 përqind e të anketuarve mendojnë se politikanët duhet të miratojnë një qasje më të qartë dhe më të hapur ndaj pajtimit ndëretnik, ndërsa vetëm 5 përqind besojnë se nuk duhet. Kjo tregon mbështetje të gjerë publike për një axhendë pajtimi më proaktive dhe pothuajse asnjë rezistencë të qartë.

Ndër të anketuarit shqiptarë, 63.1 përqind mendojnë se politikanët duhet të kenë një qasje më të qartë dhe më të hapur ndaj pajtimit ndëretnik, 32.3 përqind nuk janë të sigurt dhe 4.6 përqind janë kundër. Ndër të anketuarit serbë, shumica gjithashtu e mbështet këtë qëndrim, me 53.0 përqind që thonë po dhe 34.8 përqind të pasigurt, por kundërshtimi është më i lartë në 12.1 përqind. Të anketuarit nga komunitetet e tjera janë edhe më mbështetës, me 68.6 përqind në favor, 27.1 përqind të pasigurt dhe 4.3 përqind kundër.

Sipas gjinisë, burrat janë më qartësisht pro, me 67.5 përqind që mbështesin një axhendë më të qartë pajtimi dhe 26.2 përqind të pasigurt, krahasuar me 58.3 përqind të grave që janë pro dhe 38.1 përqind të pasigurt. Sipas moshës, mbështetja është më e fortë në grupin 25 deri në 44 vjeç, me rreth 65 përqind, dhe disi më e ulët midis grupit më të ri prej 18 deri në 24 vjeç dhe grupit më të vjetër prej 55 vjeç e lart, megjithëse në të dyja rastet ajo ende tejkalon 55 përqindëshin. Në përgjithësi, në të gjitha komunitetet dhe demografitë, marrëdhëniet ndëretnike shihen si të rëndësishme dhe ekziston një mandat i gjerë për politikanët që të miratojnë një axhendë të qartë pajtimi. Sfida kryesore politike nuk është një publik armiqësor, por si të angazhohet një mes më

i madh i pasigurtë ashtu që kjo mbështetje normative të shndërrohet në politika konkrete dhe komunikim të qëndrueshëm publik.

- **Besimi në raportimin mediatik për marrëdhëniet ndëretnike dhe pajtimin**

Rezultatet e sondazhit të opinionit tregojnë se mediat lokale veprojnë në një mjedis me besim të ulët në këtë temë të ndjeshme. Kur u pyetën se sa u besojnë mediave të Kosovës në raportimin për marrëdhëniet ndëretnike dhe pajtimin, vetëm 37.7 përqind e të anketuarve shprehën besim, ndërsa afërsisht 63.3 përqind raportuan pak ose aspak besim.

Sa besim keni në mediat në Kosovë për raportimin që lidhet me marrëdhëniet ndëretnike dhe pajtimin?

		Frekuenca	Përqindja	Përqindja Valide	Përqindja Kumulative
Valide	Kam shumë besim	116	10.0%	10.0%	10.0%
	Kam besm	311	26.7%	26.7%	36.7%
	Kam pak besim	507	43.5%	43.5%	80.2%
	Nuk kam fare besim	231	19.8%	19.8%	100.0%
	Total	1165	100.0%	100.0%	

Kur ndahen sipas etnisë, dallimet janë të theksuara. Ndër të anketuarit serbë, vetëm rreth një e pesta, 19.7 përqind, raportojnë shumë ose paksa besim në raportimin mediatik të çështjeve ndëretnike, ndërsa 80.3 përqind thonë se kanë pak ose aspak besim. Të anketuarit shqiptarë janë gjithashtu kryesisht mosbesues, me 36.9 përqind që shprehin të paktën një besim dhe 63.1 përqind që raportojnë pak ose aspak besim. Komunitetet e tjera joshumicë janë pothuajse të ndara në mënyrë të barabartë, me 50.7 përqind që raportojnë shumë ose një besim dhe rreth 49.3 përqind që raportojnë pak ose aspak besim.

Sipas gjinisë, modelet janë shumë të ngjashme, me gratë dhe burrat që tregojnë profile pothuajse identike të ulëta të besimit, afërsisht një e treta me të paktën njëfarë besimi dhe dy të tretat me pak ose aspak besim. Në të gjitha grupmoshat, besimi i pakët është përgjigjja më e zakonshme me rreth 44 deri në 45 përqind, ndërsa mungesa e besimit ndryshon nga rreth 16 deri në 25 përqind, dhe të rriturit më të rinj në grupin 25 deri në 34 vjeç dallohen pak për nivele më të larta të mungesës së besimit. Dallimet urbane dhe rurale janë margjinale, pasi të anketuarit urbanë kanë vetëm pak më shumë gjasa të raportojnë njëfarë besimi, ndërsa të anketuarit ruralë anojnë pak më shumë drejt besimit të paktë, por, sidoqoftë, në të dyja mjediset besimi i ulët mbizotëron qartë. Në përgjithësi, sondazhi zbulon një deficit strukturor të besimit në media, më të fortë te serbët e Kosovës, por të konsiderueshëm edhe te shqiptarët, gjë që krijon një sfidë të madhe për çfarëdo strategjie mediatike të orientuar drejt pajtimit, meqë aktorëve që janë normativisht të rëndësishëm dhe me ndikim nuk u besohet gjerësisht për të raportuar në mënyrë të drejtë mbi çështjet ndëretnike.

Kështu, sondazhi konfirmon një deficit strukturor të besimit në media, që është më i forti midis serbëve të Kosovës, por domethënës edhe te shqiptarët. Kjo përbën një sfidë të madhe për çdo strategji mediatike të orientuar drejt pajtimit: aktorëve që janë normativisht të rëndësishëm dhe me ndikim nuk u besohet gjerësisht për të raportuar në mënyrë të drejtë për çështjet ndëretnike.

- **Ndikimi i perceptuar i medias dhe narrativave politike**

Pavarësisht besimit të ulët, të anketuarit i atribuojnë ndikim të rëndësishëm si medias ashtu edhe narrativave të politikanëve. Rreth 75 përqind besojnë se media perceptimet publike për marrëdhëniet ndëretnike dhe pajtimin i formëson shumë ose deri në një masë.

Sipas mendimit tuaj, sa ndikim kanë mediat në Kosovë në formësimin e perceptimeve publike për marrëdhëniet ndëretnike dhe pajtimin?

		Frekuenca	Përqindja	Përqindja Valide	Përqindja Kumulative
Valide	Ndikojnë shumë	370	31.8%	31.8%	31.8%
	Ndikojnë deri në një masë	506	43.4%	43.4%	75.2%
	Ndikojnë pak	205	17.6%	17.6%	92.8%
	Nuk ndikojnë fare	84	7.2%	7.2%	100.0%
	Total	1165	100.0%	100.0%	

Sipas etnisë, ky model është përgjithësisht i qëndrueshëm, me 75.0 përqind të të anketuarve shqiptarë, 71.1 përqind të të anketuarve serbë dhe 81.1 përqind të të anketuarve nga komunitetet e tjera që ndikimin e medias e vendosin në dy kategoritë kryesore. Trende të ngjashme shfaqen midis burrave dhe grave, me 74.4 përqind dhe 74.5 përqind përkatësisht, dhe midis të anketuarve urbanë dhe ruralë, me 76.2 përqind dhe 74.4 përqind. Dallimet sipas moshës janë të vogla, me pjesën më të lartë në dy kategoritë kryesore midis të anketuarve të moshës 35 deri në 44 vjeç, me 77.2 përqind.

Kur të anketuarit pyeten se sa i formësojnë narrativat politike në Kosovë perceptimet publike për marrëdhëniet ndëretnike dhe pajtimin, politikanët dalin si forca më e madhe në përcaktimin e mënyrës se si njerëzit mendojnë për këto çështje.

Në ç'masë mendoni se ndikojnë narrativat e politikanëve në formësimin e perceptimeve publike për marrëdhëniet ndëretnike dhe pajtimin në Kosovë?

		Frekuenca	Përqindja	Përqindja Valide	Përqindja Kumulative
Valide	Ndikojnë shumë	312	26.8%	26.8%	26.8%
	Ndikojnë deri në një masë	567	48.7%	48.7%	75.4%
	Ndikojnë pak	203	17.4%	17.4%	92.9%
	Nuk ndikojnë fare	83	7.1%	7.1%	100.0%
	Total	1165	100.0%	100.0%	

Të marra së bashku, këto rezultate tregojnë se rreth tre të katërtat e të anketuarve besojnë se ajo që thonë politikanët ka një ndikim të fortë ose të moderuar në mënyrën se si publiku i kupton marrëdhëniet ndëretnike. Në hollësi, 26.8 përqind mendojnë se narrativat politike ndikojnë shumë në perceptime dhe 48.7 përqind mendojnë se ndikojnë në to deri në një farë mase. Kjo konfirmon se udhëheqësit politikë shihen si shumë ndikues në formësimin e pikëpamjeve mbi këto çështje.

Në ç'masë mendoni se narrativat e politikanëve ndikojnë në formësimin e perceptimeve publike për marrëdhëniet ndëretnike dhe pajtimin në Kosovë?

		Shqiptarët	Serbët	Të tjerët
	Ndikojnë shumë	26.3%	25.8%	34.3%
	Ndikojnë deri në një masë	48.8%	43.9%	51.4%
	Ndikojnë pak	17.3%	27.3%	10.0%
	Nuk ndikojnë fare	7.6%	3.0%	4.3%
		Total	100.0%	100.0%

Kur shqyrtojmë grupet etnike, modeli është jashtëzakonisht i qëndrueshëm. Midis të anketuarve shqiptarë, rreth një e katërta thonë se narrativat e politikanëve ndikojnë shumë në perceptime dhe pak më pak se gjysma e tyre thonë se ndikojnë deri në një farë mase. Të anketuarit serbë tregojnë nivele të ngjashme në dy kategoritë kryesore, por një pjesë dukshëm më e madhe, më shumë se një e katërta, thonë se narrativat politike ndikojnë vetëm pak në perceptimet e tyre. Të anketuarit nga komunitetet e tjera janë, nëse jo diç tjetër, më empatikët, me më shumë se një të tretën që thonë se narrativat e politikanëve ndikojnë shumë në perceptimet e tyre dhe pak më shumë se gjysma e tyre përgjigjen me deri në një farë mase, duke lënë vetëm një grup të vogël në kategoritë me pak ose aspak ndikim.

Gratë dhe burrat janë të grupuar kryesisht në dy kategori kryesore. Në mesin e grave, 24.1 përqind thonë se narrativat politike ndikojnë shumë në perceptime dhe 49.7 përqind thonë se

ndikojnë deri në një farë mase, ndërsa në mesin e burrave 29.4 përqind zgjedhin shumë dhe 47.5 përqind deri në një farë mase. Në të dyja grupet, më shumë se 70 përqind pranojnë ndikim të konsiderueshëm politik dhe vetëm një pakicë e vogël mendon se politikanët kanë pak ose aspak ndikim në pikëpamjet publike për marrëdhëniet ndëretnike.

Në të gjitha grupmoshat, një shumicë e qartë midis rreth 74 dhe 77 përqind në çdo grupmoshë besojnë se narrativat e politikanëve ndikojnë shumë ose deri në një farë mase në perceptimet e marrëdhënieve ndëretnike. Ndër të anketuarit e moshës 18 deri në 24 vjeç, 24,5 përqind thonë shumë dhe 52,1 përqind deri në një farë mase, ndërsa ndër ata të moshës 55 vjeç e më shumë përqindjet janë 35,8 përqind dhe 41,5 përqind. Kjo konfirmon se njohja e ndikimit politik ndahet gjerësisht nëpër breza, me të anketuarit më të vjetër paksa më të prirur që atë ndikim ta shohin si shumë të fortë.

Kontrasti urban dhe rural është i kufizuar. Në zonat urbane, 29.3 përqind e të anketuarve thonë se narrativat e politikanëve ndikojnë shumë në perceptime dhe 45.5 përqind deri në një farë mase, ndërsa në zonat rurale 24.9 përqind thonë shumë dhe 51.0 përqind deri në një farë mase. Në të dyja mjediset, rreth tre të katërtat e të anketuarve veten e vendosin në dy kategoritë kryesore të ndikimit.

- **A e ndihmojnë apo e pengojnë pajtimin narrativat e politikanëve?**

Pamja më e nuancuar vjen nga kjo pyetje që të anketuarit i pyet se deri në çfarë mase narrativat politike ndihmojnë ose pengojnë pajtimin ndëretnik.

Në ç'masë mendoni se narrativat e politikanëve në Kosovë e përforcojnë apo e pengojnë pajtimin ndëretnik?

		Frekuenca	Përqindja	Përqindja Valide	Përqindja Kumulative
Valide	E përforcojnë shumë	173	14.8%	14.8%	14.8%
	E përforcojnë deri në një masë	432	37.1%	37.1%	51.9%
	Nuk kanë ndikim	258	22.2%	22.2%	74.1%
	E pengojnë deri në një masë	208	17.8%	17.8%	91.9%
	E pengojnë shumë	94	8.1%	8.1%	100.0%
	Totali	1165	100.0%	100.0%	

Në nivelin e të gjithë mostrës pamja duket paksa pozitive, por shumë më ambivalente. Rreth 14.8% e të anketuarve besojnë se narrativat e politikanëve pajtimin e forcojnë "fuqishëm," dhe 37.1% se ato atë e forcojnë "deri në një masë." Të marra së bashku, pak më shumë se gjysma e popullsisë (rreth 52%) komunikimin e politikanëve e sheh si kontribues, të paktën deri në një farë mase, në pajtimin midis komuniteteve. Nga ana tjetër, 22.2% mendojnë se narrativat politike nuk kanë kurfarë ndikimi. Në të njëjtën kohë, një pakicë e konsiderueshme prej 25.9% thonë se narrativat politike pajtimin e pengojnë ose "deri në një masë" (17.8%), ose "fuqishëm" (8.1

përqind). Kjo tashmë tregon se politika perceptohet si një forcë më e kontestuar dhe me konstruktivitet më pak të besueshëm se media.

Kur ta shohim ndarjen sipas etnisë, numrat e përgjithshëm fshehin përvoja shumë të ndryshme. Midis të anketuarve shqiptarë, një shumicë e qartë prej 54.3% besojnë se narrativat e politikanëve e forcojnë pajtimin (15.9% "shumë" dhe 38.4% "deri diku"), ndërsa 24.1% mendojnë se ata e pengojnë atë dhe 21.5 përqind nuk shohin asnjë efekt. Për këtë grup, komunikimi politik, në përgjithësi, shihet si më shumë i dobishëm sesa i dëmshëm, edhe nëse një e katërta e konsiderueshme mbetet kritike. Midis të anketuarve serbë, modeli është pothuajse i përmbysur. Vetëm rreth një e treta (33.3%) konsiderojnë se narrativat e politikanëve e forcojnë pajtimin, ndërsa një shumicë e qartë prej 56.1% gjykojnë se ata e pengojnë atë, dhe vetëm 10.6% mendojnë se nuk kanë ndikim. Të anketuarit nga komunitetet e tjera janë diku në mes. 34.7% besojnë se narrativat politike e forcojnë pajtimin, 21.7% mendojnë se e pengojnë atë, dhe një shifër e habitshme prej 43.5% thonë se nuk kanë asnjë efekt fare, gjë që sugjeron një përzierje distance dhe skepticizmi.

Dallimet gjinore janë modeste. Si gratë ashtu edhe burrat kanë tendencë ta shohin një efekt pozitiv neto të narrativave politike, me pak më shumë se gjysmën në çdonjërin grup që thonë se ato e forcojnë pajtimin dhe afërsisht një të katërtën që thonë se e pengojnë atë; burrat kanë pak më shumë gjasa se gratë të mendojnë se narrativat pajtimin e pengojnë "fort," por balanca e përgjithshme është e ngjashme. Mosha dhe vendbanimi gjithashtu nuk e ndryshojnë rrënjësisht pamjen: në të gjitha grupmoshat dhe midis zonave urbane dhe rurale, më shumë njerëz thonë se narrativat politike ndihmojnë sesa pengojnë, por leximi pozitiv nuk është mbizotërues në asnjë grup.

Përfundimi

Sondazhet e opinionit publik tregojnë një asimetri themelore që është në thelb të marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë. Qytetarët e të gjitha komuniteteve përgjithësisht dëshirojnë marrëdhënie më të mira dhe presin më shumë nga udhëheqësit e tyre, mirëpo ata kanë pak besim te aktorët dhe kanalet që e formësojnë bisedën publike. Marrëdhëniet ndëretnike dhe pajtimi nuk janë shqetësime anësore. Afërsisht katër në pesë të anketuar këto çështje i konsiderojnë si të rëndësishme ose shumë të rëndësishme në jetët e tyre, dhe gati dy të tretat duan që politikanët ta përcaktojnë një axhendë më të qartë dhe më të hapur për promovimin e pajtimit. Ky model shfaqet midis komuniteteve shqiptare, serbe dhe komuniteteve të tjera, në të gjitha grupmoshat dhe në zonat urbane dhe rurale, gjë që tregon se publiku nuk është indiferent dhe se pajtimi njihet gjerësisht si pjesë e së ardhmes politike të Kosovës.

Në të njëjtën kohë, arkitektura e besimit rreth kësaj axhende është jashtëzakonisht e brishtë. Mediave, të cilat qytetarët i shohin si përcaktues të fuqishëm të axhendës për çështjet ndëretnike, u besohet shumë pak në këtë temë. Vetëm rreth një e treta e të anketuarve shprehin ndonjë shkallë besimi në raportimin mediatik mbi marrëdhëniet ndëretnike dhe pajtimin, ndërsa afërsisht dy të tretat thonë se kanë pak ose aspak besim. Pamja është më e zymtë midis të

anketuarve serbë, më shumë se 80 përqind e të cilëve raportojnë besim të ulët ose kurfarë besimi, por edhe shqiptarët anojnë qartë nga mosbesimi, ndërsa komunitetet e tjera janë të ndara pothuajse në mënyrë të barabartë. Çdo përpjekje për të promovuar narrativa më të nuancuara duhet të veprojë në një mjedis ku ndërmjetësit kryesorë njihen si me ndikim, por nuk shihen si të drejtë ose të besueshëm, dhe posaçërisht nga komunitetet që ndihen më të cenueshme.

Perceptimet e ndikimit politik ndjekin një logjikë të ngjashme, megjithëse jo identike. Rreth tre të katërtat e të anketuarve besojnë se narrativat politike formësojnë ndjeshëm pikëpamjet publike për marrëdhëniet ndëretnike dhe pajtimin. Ky gjykim është i qëndrueshëm në të gjitha grupet etnike, gjinitë, grupmoshat dhe llojet e vendbanimeve. Qytetarët në mënyrë të qartë politikanët nuk i shohin si margjinalë ndaj dinamikave ndëretnike. Përkundrazi, ata pranojnë se gjuha dhe kornizat politike kanë fuqi të vërtetë për të strukturuar mënyrën se si njerëzit mendojnë për komunitetet e tjera, për rrezikun dhe për perspektivat e të jetuarit së bashku. Ajo që ndryshon nuk është njohja e ndikimit, por mënyra se si vlerësohet ky ndikim.

Kur të anketuarit u pyetën nëse narrativat politike e forcojnë apo e pengojnë pajtimin, pamja e përgjithshme është paksa pozitive, por e ndarë përgjatë vijave etnike. Në nivelin kombëtar, pak më shumë se gjysma e të anketuarve mendojnë se narrativat politike pajtimin e forcojnë, ose shumë, ose deri diku, rreth një e katërta besojnë se e pengojnë atë dhe rreth një e pesta nuk shohin ndonjë ndikim të vërtetë në asnjërën anë. Midis të anketuarve shqiptarë, ky lexim pozitiv neto është i vlefshëm, pasi një shumicë e qartë narrativat politike i shohin si kontribuese në pajtim, megjithëse një pakicë e konsiderueshme mbetet skeptike ose kritike. Në mesin e të anketuarve serbë, modeli është pothuajse i përmbysur, me një shumicë që gjykon se narrativat politike e pengojnë pajtimin dhe vetëm rreth një e treta ato i përjeton si mbështetëse. Të anketuarit nga komunitetet e tjera joshumicë më shpesh thonë se narrativat politike nuk kanë asnjë efekt fare, duke kombinuar distancën nga diskursi kryesor me një tendencë modeste për ta parë atë pak më shumë si të dobishme sesa si të dëmshme.

Këto gjetje kanë disa implikime. Së pari, Kosova nuk duket se përballet me një krizë pajtimi nga ana e kërkesës. Qytetarët në të gjitha komunitetet vlerësojnë marrëdhëniet e mira ndëretnike dhe, në parim, janë të hapur ndaj një axhende më të fortë politike mbi këto çështje. Bllokimi qëndron diku tjetër, në besimin e ulët tek rojet e portave, në përvojat jo të njëjta të diskursit politik dhe në një mjedis informativ brenda të cilit komunitetet e ndryshme janë të vendosura në mënyra shumë të ndryshme. Së dyti, të dhënat nënvizojnë se media dhe aktorët politikë luajnë një rol me dy tehe. Ato perceptohen si të fuqishme në formësimin e perceptimeve, megjithatë u mungon besueshmëria ndërkomunitare për ta përdorur atë pushtet si urë dhe jo si pykë. Për të anketuarit serbë në veçanti, narrativat e institucioneve qendrore nuk janë thjesht joefektive, ato shihen si dëmtuese aktive të pajtimit. Për komunitetet e tjera joshumicë, diskursi politik rrezikon të bëhet i parëndësishëm. Për shqiptarët, në të kundërt, të njëjtat narrativa kanë më shumë gjasa të interpretohen si gjerësisht pozitive ose të paktën të pranueshme. Ky boshllëk bëhet një nxitës i mosbesimit në vetvete.

Së fundmi, grupi i madh i të anketuarve që janë të pasigurt për disa pyetje, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me një axhendë të pajtimit politik, meriton vëmendje të kujdesshme. Afërsisht një e treta nuk janë të sigurt nëse politikanët duhet të kenë një axhendë më të qartë për pajtimin. Ky grup përfshin një pjesë disproporcionale të grave, serbëve dhe të disa grupmoshave më të reja dhe më të vjetra. Ata nuk janë as mbështetës të qartë dhe as kundërshtarë të vendosur, por një elektorat fluid, qëndrimet e të cilit mund të ndryshojnë si reagim ndaj përvojave konkrete dhe sinjaleve të besueshme. Për politikëbërësit dhe shoqërinë civile, ata përfaqësojnë si rrezik ashtu edhe mundësi. Nëse pasiguria e tyre mbushet nga narrativa polarizuese dhe kriza sporadike, ata mund të shkojnë drejt tërheqjes dhe cinizmit. Nëse, në vend të kësaj, hasin përmirësime të prekshme, mesazhe gjithëpërfshirëse dhe bashkëpunim të dukshëm ndërkomunitar, ata mund të bëhen një forcë stabilizuese për një axhendë më të qëndrueshme pajtimi.

Konkluzione dhe Rekomandime

Që të katër seksionet e këtij studimi, përkatësisht diskursi i elitës politike, dëshmitë e shoqërisë civile, praktikat mediatike dhe omnibus sondazhi, e tregojnë një diagnozë të qëndrueshme dhe në disa aspekte shpresëdhënëse të marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë. Gjetja qendrore është se temperatura e marrëdhënieve formësohet shumë më pak nga ndjenjat e komunitetit sesa nga mënyrat se si një grup relativisht i vogël aktorësh politikë dhe mediatikë i përcaktojnë dallimet, incidentet dhe bashkëpunimin. Kur elitat mbështeten në narrativa të ashpra, të fokusuara në siguri, dhe posaçërisht në momente krize, ato e amplifikojnë polarizimin edhe pse bashkëjetesa e përditshme dhe interesat e përbashkëta vazhdojnë nën nivelin e politikës kryesore.

Intervistat me udhëheqësit politikë dhe analiza e mediave sociale këtë dinamikë të drejtuar nga elita e theksojnë në terma të mprehtë. Në të gjithë partitë kryesore shqiptare dhe në Listën Serbe, komunikimi ndëretnik mbizotërohet nga një kornizë e linjës së ashpër, që sigurinë e vë në plan të parë, me pothuajse asnjë investim të qëndrueshëm në narrativa pajtuese. Në rastin e Listës Serbe, kjo përfshin gjithashtu një sasi të konsiderueshme stigmatizimi të qartë. AAK-ja mban një repertor të përzier, por ende mbështetet shumë në mesazhe të sigurimuara, ndërsa Nenad Rašići shfaqet si një i përjashtuar margjinal, komunikimi i të cilit është kryesisht jo-konfrontues. Ky mjedis në hapësirën e informacionit të qytetarëve e normalizon një axhendë të përqendruar në konflikt dhe dërgon sinjale të përsëritura se dialogu është diçka e veçantë, i rrezikshëm ose i paligjshëm dhe jo një pjesë rutinore e jetës demokratike.

Udhëheqësit e shoqërisë civile që veprojnë në të njëjtin mjedis, përshkruajnë një asimetri të vazhdueshme të ndikimit. Ata mund të mbajnë kontaktin, të ndërtojnë besim në mikro-nivel dhe të gjenerojnë kundër-narrativa përmes koalicioneve, edukimit qytetar, demaskimit dhe rrëfimit të historive, mirëpo këto përfitime mbeten strukturalisht të brishta. Tronditjet periodike, të tilla si retorika përshkallëzuese, fushatat e shpifjes ose incidentet e sigurisë, mund të fshijnë shumë shpejt vite të tëra të punës graduale. Tkurrja e hapësirës qytetare, delegjitimimi i politizuar i ndërtuesve të urave, narrativat e pazgjidhura të luftës së viteve 1990 dhe pasiguria kronike e financimit, të gjitha ngushtojnë hapësirën për iniciativa të qëndrueshme pajtimi. Pamja e përgjithshme nuk është ajo e dështimit të shoqërisë civile, por e suksesit të kushtëzuar, ku progresi është i mundur, por që duhet të rivendoset sa herë që aktorët shtetërorë dhe partiakë të dërgojnë sinjale përjashtuese në vend të mesazheve pajtuese.

Mjedisi mediatik zë një hapësirë midis përmbajtjes dhe polarizimit. Mediat kryesore në gjuhën shqipe dhe serbe, sipas shumicës së të dhënave, janë më të disiplinuara profesionalisht sesa në të kaluarën, me Kodin e Etikës, mbështetjen e donatorëve dhe mësimet e vështira nga viti 2004 dhe 2008 që kanë reduktuar gjuhën e hapur të urrejtjes dhe stereotipet e ashpra etnike. Megjithatë, nga ana strukturore, mbulimi mbetet i anuar drejt sigurisë, krizës dhe politikës së lartë, me pak vëmendje të qëndrueshme ndaj bashkëjetesës së përditshme, interesave të përbashkëta ose bashkëpunimit lokal. Kufizimet strukturore, veçanërisht deficitet gjuhësore midis gazetarëve, prania e kufizuar në terren në zonat me shumicë serbe dhe dy ekosisteme

informative që kryesisht janë paralele, e përforcojnë atë që mund të përshkruhet si një stereotip mungese, në të cilin jeta e zakonshme ndërkomunitare thjesht nuk shfaqet në lajme, ndërsa një rrip mediatik i politizuar dhe i drejtuar nga klikimet përfiton nga identiteti dhe pakënaqësitë.

Sondazhi i opinionit shton një perspektivë thelbësore nga poshtë lart. Ai tregon se marrëdhëniet ndëretnike dhe pajtimi nuk janë shqetësime anësore për qytetarët, pasi gati katër në pesë të anketuar ato i konsiderojnë të rëndësishme ose shumë të rëndësishme në jetën e tyre dhe gati dy të tretat duan që udhëheqësit politikë ta përcaktojnë një axhendë më të qartë dhe më të hapur për avancimin e pajtimit. Në të njëjtën kohë, besimi te ndërmjetësit kryesorë është shumë i ulët. Mediat shihen gjerësisht si me ndikim në çështjet ndëretnike, por atyre u beson vetëm rreth një e treta e të anketuarve në përgjithësi, me një mosbesim veçanërisht të mprehtë midis serbëve të Kosovës. Narrativat politike njihen gjithashtu si përcaktues të fuqishëm të axhendës, dhe shumica të mëdha në të gjitha grupet besojnë se ato formësojnë ndjeshëm perceptimet e marrëdhënieve ndëretnike. Megjithatë, vlerësimet e ndikimit të tyre ndryshojnë ndjeshëm, me të anketuarit shqiptarë që kanë tendencë të shohin një efekt pozitiv neto, të anketuarit serbë një efekt tejet negativ dhe komunitetet e tjera që tregojnë një përzierje distancimi dhe skepticizmi.

Të marra së bashku, këto rryma tregojnë një asimetri themelore. Në nivelin shoqëror ekziston një kërkesë e konsiderueshme latente për marrëdhënie ndëretnike më konstruktive dhe për një axhendë politike që pajtimin e merr seriozisht. Megjithatë, në nivelin institucional, aktorët më të pozicionuar për t'iu përgjigjur kësaj kërkese, veçanërisht elitat politike, shumë shpesh prodhojnë narrativa të sigurimuara dhe nganjëherë stigmatizuese që qarkullojnë në një mjedis informativ me besim të ulët. Shoqëria civile dhe media profesionale demonstrojnë, në miniaturë, se praktikat më konstruktive janë të mundshme, por ato mbeten të kufizuara nga sinjalet dhe veprimet politike të përcaktuara nga lart.

Rekomandime:

Duke u bazuar në këto gjetje, rekomandimet e mëposhtme synojnë ta përafrojnë lidershipin politik, praktikat mediatike dhe nismat e shoqërisë civile me kërkesën më të gjerë shoqërore për marrëdhënie ndëretnike më konstruktive dhe më gjithëpërfshirëse në Kosovë.

- Presidenca, Qeveria, Kuvendi dhe partitë politike duhet të angazhohen për një doktrinë të të folurit të përgjegjshëm që shmang gjuhën e urrejtjes, fyerjet etnike dhe fajësimin kolektiv, hedh poshtë kornizat e ekzagjeruara të fokusuara në siguri që i portretizojnë të gjitha komunitetet si kërcënime, dhe që përdorin gjuhë të bazuar në fakte që është e qetë në kriza dhe e fokusuar në uljen e tensioneve dhe në të drejta, dhe posaçërisht në kohë krize. Ky standard duhet të përfshihet në rregullat e partive dhe strategjitë e komunikimit, dhe retorika gjithëpërfshirëse duhet të përputhet me garanci konkrete përmes zbatimit të vazhdueshëm të të drejtave gjuhësore, përfaqësimit proporcional të komuniteteve jo-shumicë në institucionet publike dhe konsultimit transparent me përfaqësuesit e zgjedhur lokalë të komuniteteve serbe dhe të komuniteteve të tjera joshumicë.

- Mediat publike dhe ato private të mëdha duhet të investojnë në kapacitetet gjuhësore shqip-serbisht dhe në projekte të përbashkëta editoriale, në mënyrë që temat e ndjeshme si Kosova Veriore, komunat e përziera dhe incidentet e sigurisë të raportohen nga terreni në një mënyrë profesionale, gjithëpërfshirëse dhe dygjuhëshe. Donatorët dhe rregullatorët duhet të mbështesin dhe nxisin përmbajtje që nxjerr në pah bashkëjetesën e përditshme, interesat e përbashkëta ekonomike dhe bashkëpunimin lokal, për të kundërbalancuar stimujt komercialë për raportimin e përqendruar në konflikt dhe të mbështetur në klikime.
- Udhëheqësit politikë dhe zyrtarët shtetërorë duhet të përmbahen nga delegjitimimi i nismave ndëretnike dhe në vend të kësaj duhet ta afirmojnë publikisht punën e aktorëve të shoqërisë civile të angazhuar në dialog, drejtësi tranzicionale dhe të drejtat e grupeve jo-shumicë. Projektet e rrëfimit të storjeve që dokumentojnë bashkëpunimin praktik ndër-komunitar dhe përvojat e përbashkëta duhet të lidhen sistematikisht me mediat kryesore dhe lokale, në vend që të mbeten të kufizuara në raportet e projekteve.